

# Trendet zgjedhore 2000-2014

Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe  
përfaqësimit



Democracy for Development  
Demokraci për zhvillim  
Demokratija za razvoj

# Trendet zgjedhore 2000-2014

Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe  
përfaqësimit

Prishtinë, korrik 2015

Copyright © 2015. Instituti Demokracia për zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përveç për citate të shkurtra për qëllime të kritikës dhe shqyrtimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sistem arkivimi, ose të transmetohet në çfarëdo forme ose mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Punimi i përgatitur nga:

Leon Malazogu

Me kontributin dhe ndihmën në hulumtim nga:

Ngadhujim Halilaj dhe Rezarta Delibashzade

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit për reformën zgjedhore, Analiza e trendeve zgjedhore në Kosovë, e financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës dhe Departamenti Federal për Punë të Jashtme i Zvicrës. Mbështetur pjesërisht nga granti Fondacionet për shoqëri të hapur. Përmbajtja e këtij punimi është vetëm përgjegjësi e Demokracisë për zhvillim (D4D), dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton pozicionin e Ministrit të Punëve të Jashtme të Holandës dhe Departamentit Federal për Punë të Jashtme të Zvicrës, dhe as Fondacionit për Shoqëri të Hapur.

## Përmbajtja

Përmbledhje	5
Hyrje	7
Zgjedhjet nga 2000 deri 2014	10
<i>Përvoja me sistemin zgjedhor</i>	12
Elektorati dhe pjesëmarrja në votime	16
<i>Lista e votuesve</i>	16
<i>Pjesëmarrja e vërtetë në votime</i>	19
<i>Votimi me postë dhe me kusht</i>	22
<i>Votat e pavlefshme</i>	25
Efekti në sjellje në votim	31
<i>Kuota gjinore</i>	31
<i>Listat e hapura</i>	34
<i>Vota preferenciale</i>	37
<i>Si bëhet zgjedhja?</i>	38
<i>Pesha e lidershit</i>	38
Marrëdhënia me politikën	41
<i>Kontakti me përfaqësuesit</i>	41
<i>Anëtarësimi dhe afërsia me parti</i>	44
Trendet në votim	50
<i>Trendi në të ardhmen</i>	63
<i>Ndërrimi i zgjedhjes?</i>	70
<i>Zgjedhja e dytë</i>	73
<i>Popullariteti i liderëve në mesin e simpatizantëve të partive të tjera</i>	75
Konkluzionet	81
Endnote	86



## Përmbledhje

Dhjetë palë zgjedhje gjatë një periudhe prej pesëmbëdhjetë vjetësh ofrojnë distancë të mjaftueshme kohore për të vlerësuar si e kuptojmë dhe ushtrojmë ne demokracinë. Duke pasur parasysh se nuk do të ketë zgjedhje së shpejti, dy vitet e ardhme paraqesin mundësi të shkëlqyer për të reflektuar dhe përmirësuar përvojën zgjedhore. Ky punim prezanton një sërë trendesh dhe nxjerr përfundime dhe analiza në mënyrë neutrale për t'i informuar politik-bërësit të cilët mund të debatojnë lidhur me dizajnin elektorale në të ardhmen.

Matja e evolucionit të demokracisë tonë kërkon perspektivë kohore. Suksesi i një reforme kërkon një vegël matëse për të krahasuar nëse ka pasur përparim gjatë viteve të kaluara. Ndonëse në fazë të hershme, demokracia kosovare ka filluar të tregojë disa shenja të konsolidimit, që dëshmohet me zvogëlimin e numrit të partive që garojnë në zgjedhje, që mandatet e kohëve të fundit kanë filluar të jenë më jetëgjata, si dhe me kalimin e tri gjysmë-transicioneve paqësore.

Në gjysmën e parë të hulumtimit, kemi krahasuar shifrat zyrtare të nxjerra nga KQZ-ja që kanë të bëjnë me listën e votuesve, pjesëmarrjen në votime, performancën e partive, votat individuale, në përpjekje për ta shikuar në trendin afatgjatë dhe se çfarë kuptimi mund të nxirret si rezultat.

Punimi fillon duke analizuar arsyet që qëndrojnë prapa rritjes së fletëvotimeve të pavlefshme dhe atyre të dëmtuara, që nuk do të ndodhte po të kishim zona zgjedhore. Kemi tërhequr vërejtjen mos të organizohen më disa palë zgjedhje në të njëjtën ditë, posaçërisht nëse fletëvotimi nuk thjeshtohet. Është për habi kur vërehet se ndonëse të gjithë votuesve u ishin dhënë tre fletëvotime, rreth një e gjashta e votave nuk kishin hedhur fletëvotimin për këshillin komunal, që është një tregues i fuqishëm i mashtrimit potencial.

Lista e votuesve është përmirësuar kohëve të fundit, që na jep kurajo se mund të bëhet edhe më shumë. Saktësimi i mëtejshëm i listës së votuesve do të mund të ishte në interesin e politikanëve të popullarizuar të cilët do të zgjidheshin me një pjesëmarrje më të lartë të votuesve. Pjesëmarrja reale në zgjedhje është afër dy të tretave, dëshmi se nuk ka krizë të daljes siç duket nga rezultatet zyrtare. Është e vështirë dhe e kushtueshme të punohet me shifra zyrtare për shkak se shumë shifra mungojnë dhe se një pjesë e të dhënave nuk publikohet në mënyrë të njëtrajtshme nga viti në vit.

Në gjysmën e dytë të punimit krahasohen rezultatet e tri anketave të opinionit publik - si kosovarët perceptojnë udhëheqësinë e tyre, institucionet që janë përgjegjëse për zgjedhjet, anëtarësinë e partisë – të cilat gjithashtu janë kros-tabuluar me faktorë demografik. Gjithnjë e më tepër, votuesit ndërrojnë partinë e tyre të preferuar – nga viti 2007 deri më 2010, rreth gjysma e respondentëve e kanë ndryshuar zgjedhjen sa i përket partisë së tyre. Respondentët e moshës mesatare, ata me arsimim të lartë dhe gratë përbëjnë pjesën më të madhe të votuesve të luhatur dhe për këtë arsye ata do të duhej të jenë pikësynim i fushatave politike në të ardhmen.

Njëri nga trendet në rritje është se sa më të mëdha të jenë të ardhurat e personit, aq më shumë ka të ngjarë që ai/ajo ta ketë takuar një zyrtar publik. Anëtarë të partive zakonisht janë të arsimuarit dhe ata të moshave mes 35 dhe 44 vjeç. Numri i atyre që ndiheshin shumë afër partisë së tyre ka rënë nga 25% në 15%, gjersa shkalla e kosovarëve që nuk ndihen të afërt me politikën është rritur.

## Hyrje

Trendet zgjedhore evoluojnë ngadalë, nuk vërehen me sy të lirë dhe analiza e tyre ka kuptim për një periudhë më të gjatë kohore. Ky vit është moment i përshtatshëm për të reflektuar pasi që Kosova shënon pesëmbëdhjetë vjet nga zgjedhjet e para demokratike. Pesë palë zgjedhjesh komunale dhe pesë palë zgjedhjesh të përgjithshme ofrojnë një distancë të mjaftueshme për të nxjerrë bilancin e evolucionit demokratik.

Demokracia kosovare doli me hematoma nga zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2010, por përmirësimet e zgjedhjeve në vitin 2013 dhe 2014 janë shpresë për të ardhmen. Tani është momenti i shkëlqyer për të reflektuar, pasi që para nesh kemi dy vjet pa zgjedhje, që mund të shfrytëzohen për të bërë ndryshimet që kërkohen për përmirësimin e kornizës zgjedhore. Reformat zgjedhore janë diskutuar shumë gjatë dekadës së fundit, por nuk ka pasur ndryshime tjera nga viti 2007 (kur u arritën listat e hapura dhe zgjedhja e kryetarëve të komunave në mënyrë të drejtpërdrejtë në vitin 2007). Të gjithë hisedarët – organizatat joqeveritare, partitë politike dhe bashkësia ndërkombëtare – kanë ide të mjaftueshme se çfarë do të duhej të ndryshonte në arkitekturën zgjedhore të Kosovës. Për t'u angazhuar drejt reformave serioze, ky punim shërben si tabelë pasqyruese për të vlerësuar historinë tonë zgjedhore.

Ky studim evidenton treguesit kryesorë që kanë të bëjnë me zgjedhjet, e që shërben si referencë e dobishme për një debat sa më gjithëpërfshirës lidhur me sistemin zgjedhor. Madje edhe syri i trajnuar më së miri dhe vëzhguesit më me përvojë të zgjedhjeve vështirë se mund ta shohin atë që vetëm numrat mund ta tregojnë. Me ndihmë të numrave, ne kemi zbuluar më parë<sup>1</sup> se në dy komuna ishin dëmtuar më shumë fletëvotime se në të gjitha komunat tjera të vendit, një tregues i qartë i mashtrimit. Ne i kemi analizuar edhe trendet zgjedhore që përfshijnë tre palë zgjedhjet e para, e publikuar



në vitin 2011.<sup>2</sup> Këtë herë, ne kemi përfshirë më shumë tregues dhe për vitet nga 2000 deri më 2014. Pasi që të dhënat origjinale të siguruara nga autoriteti i zgjedhjeve janë prezantuar në format ndryshe nga viti në vit, përfshirja e të dhënave ka kërkuar futjen e tyre manuale.

Në gjysmën e parë të punimit trajtohen dhe analizohen rezultatet zyrtare të KQZ-së. Punimi fillon me trajtimin e kohëzgjatjes së mandateve dhe të partive në qeveri, për të parë nëse Kosova e ka ndjekur parimin e katër vjetëve, si dhe nëse iu është nënshtruar transicioneve paqësore – tregues kryesor i konsolidimit demokratik. Në punim pastaj përshkruhen veçoritë e ndryshme të sistemit zgjedhor që janë përdorur në Kosovë gjatë gjithë kësaj periudhe dhe ndryshimet që kanë ndodhur me kalimin e kohës. Këtu trajtohen edhe ndryshimet kryesore të vitin 2007 si dhe mësimet e nxjerra që mund të informojnë ndryshimet e ndryshme në të ardhmen. Në pjesën e tretë krahasohet rritja e numrit të votuesve në listën e votuesve me të dhënat nga regjistrimi i popullsisë dhe e vendos pjesëmarrjen në votime në një perspektivë më të saktë. Në pjesën pasuese trajtohen kuota gjinore, listat e hapura dhe vota preferenciale, e që pasohet me analizën e votës që ka fituar lideri i secilës parti si pjesë e votave të partisë së tyre.

Përveç analizës sonë të të dhënave zyrtare të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), D4D ka kryer tre anketa të njëpasnjëshme, me rreth 18 muaj distancë ndërmjet vete, në vitin 2012, 2014 dhe 2015. Gjersa rezultatet e anketës së parë janë publikuar më parë, në gjysmën e dytë të këtij punimi analizohet trendi më afatgjatë dhe përfshin pyetje të reja. Anketa e vitit 2012 është zhvilluar nga Index Kosova, dhe shumë prej këtyre të dhënave tashmë janë publikuar. Anketat e viteve 2014 dhe 2015 janë kryer nga Ubo Consulting dhe në të gjitha (të tri raundet), mostra përfshinte mbi 1000 të anketuar, duke përdorur mostrën e rastit, ndërsa zgjedhja e të anketuarve është bërë duke përdorur metodën e teknikës

së ecjes, duke e zgjedhur çdo të tretën shtëpi në të majtë. Vetëm pyetjet që ishin shtruar në mënyrë identike dhe që kishin një sërë përgjigjesh identike u krahasuan përgjatë viteve. Ndër të tjera, D4D i është mirënjohës për kontributin Ngadhujm Halilajt, i cili në mënyrë të palodhshme e kishte organizuar futjen e të dhënave dhe krijimin e grafikëve për t'i përmbushur pritjet e këtij raporti kërkuar. Për shkak të hapësirës së kufizuar, disa nga grafikonet përmbajnë shkurtesa si ND (nuk di), NV (nuk do të votoj/nuk kam votuar), PP (pa përgjigje), PV (të pavendosur) dhe Ref (refuzon të përgjigjet).

## Zgjedhjet nga 2000 deri 2014

Kanë kaluar pesëmbëdhjetë vite që kur Kosova kishte mbajtur zgjedhjet e veta të para demokratike – zgjedhjet për kuvendet komunale në vitin 2000, atëherë nën Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Që nga atëherë, Kosova ka kaluar nëpër katër zgjedhje të tjera komunale dhe pesë zgjedhje të përgjithshme.

Zgjedhjet për kuvendet komunale dhe kryetarë të komunave që nga viti 2000			
Data	Kuvendi Komunal	Kryetarë të Komunave	Kohëzgjatja (vite)
28.10.2000	Mandati I (2000-2002)		2 (jo i plotë)
26.10.2002	Mandati II (2002-2007)		5 (i zgjatur)
17.11.2007	Mandati III (2007-2009)	x	2 (jo i plotë)
15.11.2009	Mandati IV (2009-2013)	x	4 (Mandati i parë i plotë)
03.11.2013	Mandati V (2013-aktual)	x	

Me një përjashtim, mandatet zgjedhore në Kosovë nuk kanë zgjatur katër vite – që tregon mungesë të konsolidimit dhe të pjekurisë demokratike. Fatmirësisht, pas një dekade përpjekjesh, mandati i katërt i zgjedhjeve komunale zgjati katër vite të plota dhe mandati i katërt i zgjedhjeve të përgjithshme ka zgjatur gati një mandat të plotë (u ndërpre gjashtë muaj më herët me zgjedhje të jashtëzakonshme). Këto janë shenja të një pjekurie graduale, edhe pse mbetet akoma shumë për t'u bërë.

Zgjedhjet e përgjithshme që nga viti 2001			
Data	Mandati	Kohëzgjatja (vite)	Tranzicioni
17.11.2001	Mandati I (2001-2004)	3 (jo i plotë)	LDK-PDK-AAK & të tjerët
23.10.2004	Mandati II (2004-2007)	3 (jo i plotë)	LDK-AAK
17.11.2007	Mandati III (2007-2010)	3 (jo i plotë)	PDK-LDK
12.12.2010	Mandati IV (2010-2014)	4 (jo i plotë)	PDK & të tjerët (i pari(1))
08.06.2014	Mandati V (2014-aktual)		PDK-LDK


Përveç kohëzgjatjes së mandateve, një indikator matës i rëndësishëm është nëse Kosova ka kaluar dy tranzicione paqësore, të cilat Robert Putnam i konsideron si test kryesor të lakmuesit për të vlerësuar konsolidimin demokratik. Edhe pse Kosova ka përjetuar ndërrimin e pushtetit, mbetet kontestuese nëse këto ndryshime ishin tranzicioni i plotë i pushtetit apo jo. Mes viteve 2001 dhe 2004, LDK ka qeverisur me disa parti dhe në vitin 2004 ajo kishte lidhur koalicion me AAK-në (gjysmë tranzicioni i parë duke qenë se PDK kaloi në opozitë). Në vitin 2007, PDK i fiton zgjedhjet dhe e zgjedh LDK-në si partnerin e saj më të vogël të koalicionit, mbase ky është gjysmë tranzicioni i dytë. Në vitin 2010 PDK vazhdon të qeverisë me të tjerët, ndërsa LDK shkon në opozitë. Pas një bllokade prej gjashtë muajsh në vitin 2014, LDK kthehet në pushtet me partinë që ka qenë në pushtet gjatë shtatë viteve të kaluara, PDK-në. Në variantin më të mirë, del se Kosova ka kaluar tri gjysmë tranzicione paqësore ku ndërrimi i pushtetit është shënuar me ndërrimin e një partneri të koalicionit, përderisa tjetri ka vazhduar të qeverisë me partnerë të tjerë.

## *Përvoja me sistemin zgjedhor*


Veçoritë kryesore të sistemit zgjedhor në Kosovë kanë qenë konsistente. Në fillim u zgjodh sistemi proporcional nga UNMIK-u si sistemi më i përshtatshëm duke pasur parasysh periudhën e pasluftës dhe ndarjet shoqërore. Në vendet me potencial për konflikt, asnjë parti nuk duhet të mbesë me më pak ulëse se sa përqindja e rezultatit zgjedhor që ka fituar. Një sistem proporcional, që në mënyrë rigoroze i shndërron përqindjet në ulëse ishte zgjedhje e mençur dhe e drejtë që parandalon konfliktin potencial.

Tabela në faqen tjetër ilustron llojin e zgjedhjeve dhe tiparet e përdorura gjatë gjithë këtyre viteve. Në vitin 2003, një fushatë e madhe e shoqërisë civile çoi në përdorimin e listave të hapura dhe në zgjedhjen e drejtpërdrejtë të kryetarëve të komunave, që u përdor për herë të parë në vitin 2007. Avokimi për zonat zgjedhore dështoi kundrejt rezistencës së madhe politike. Si një hap prapa, e njëjta valë e ndryshimeve solli një prag të lartë zgjedhor që kishte për synim krijimin e koalicioneve qeverisëse stabile.

Futja në përdorim e listave të hapura pa zona zgjedhore e vështirësoi votimin. Në mënyrë që fletëvotimi të mos arrinte madhësinë e një libri (110 emra për secilën parti), emrat u publikuan në një libërth të veçantë, që vendosej në çdo kabinë votimi. Efekti tjetër anësor i një zone të vetme zgjedhore me lista të hapura ishte rreziku që emrat e partisë që gjendeshin në pjesën e sipërme të listës të përfitonin padrejtësisht nga radhitja. Për të parandaluar një dominim të emrave të kreut të listës garuese, OSBE-ja lloboi me sukses që të përdorej vota preferenciale. Çdo votues në fillim duhej ta gjente partinë e preferuar dhe pastaj t'i identifikonte deri në dhjetë emra në listën prej 110 emrash dhe t'i shënonte numrat gjegjës në fletëvotim (shih më poshtë pjesën e sipërme të fletëvotimit që përdorej në vitin 2014 – vegëza tek fletëvotimi i plotë).<sup>3</sup>











Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Komiteti Qendror i Zgjedhjeve  
Central Election Committee



**ZGJEDHJET E PARAKONSHME PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2014**  
**PREVREMENI IZBORI ZA SKUPŠTINU REPUBLIKE KOSOVO 2014**

**1** Shënjeni **VETËM NJË** subjekt politik  
Oznaçite **SAMO JEDAN** politički subjekat

- 31.  PLE - PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE
- 32.  PDAK - PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS
- 33.  PDS - PROGRESIVNA DEMOKRATSKA STRANKA
- 34.  PREBK - PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS
- 35.  Lëvizja VETËVENDOSJEI
- 36.  VAKAT - KOALICIJA VAKAT
- 37.  PF - PARTIA E FORTË
- 38. SRPSKA LISTA
- 39.  PDP - POKRET ZA DEMOKRATSKI PROSPERITET

**2** Shënjeni **MË SË SHUMTI PESË** kandidat  
Oznaçite **NAJVISË PET** kandidata

1	2	3	4
5	6	7	8
9	10	11	12
13	14	15	16
17	18	19	20
21	22	23	24
25	26	27	28
29	30	31	32
33	34	35	36

Paralelisht me futjen në përdorim me gjysmë zemre të disa tipareve të reja, Kosova mbajti tre palë zgjedhje në një ditë. Nga votuesit pritej që t'i vinin deri në 23 shenja një pas një (partia + 10 emra për zgjedhjet e përgjithshme, partia + 10 emra për zgjedhjet komunale dhe një shenjë për kryetar të komunës). Ata që votuan në balotazh arritën të vinin edhe shenjen e 24 katër javë më vonë.

13

## Veçoritë zgjedhore (sipas vitit të zgjedhjeve)

	2000	2001	2002	2004	2007	2009	2010	2012	2013	2014
Data	28.10. 2014	17.11. 2014	26.10. 2014	23.10. 2014	17.11. 2014	15.11. 2014	12.12. 2014	zgjedhje të ndërmjetme	03.11. 2014	08.06. 2014
Lloji i zgjedhjeve	Kuvend Kom.	Parl.	Kuvend Kom.	Parl.	Parl. Kuvend Kom. Kryetar Kom.	Kuvend Komunal Kryetar Komune	Parl.	Ferizaj/ Kaçanik	Kuvend Komunal Kryetar Komune	Parl.
Listat	Lista të hapura	Lista të mbyllura (1/3 kuota gjinore)			Lista të hapura (1/3 kuota gjinore)					
Zgjedhjet	Vetëm një emër				1+10 emra	1+1 emra	5 emra			
Pragu	Nuk ka				5% për zgjedhjet e përgjithshme; Nuk ka prag për zgjedhjet komunale					
Kryetari i Komunës	Kryesuesi zgjidhet nga Kuvendi				Kryetari i Komunës zgjidhet drejtpërdrejt					
Sistemi	Proporcional (Shndërrimi i numrit të votave në numër të vendeve sipas formulës Saint-Lague)									
Zonat zgjedhore	Nuk ka zona zgjedhore - Kosova është një zonë e vetme zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme, siç janë komunat.									

Ende ka tendenca që të mbyllen listat, që herë pas here ngjallen nga politikanë me ndikim larg vëmendjes së mediave. Edhe pjesë të bashkësisë ndërkombëtare joformalisht avokojnë për mbyllje të listave, gjoja për shkak të konfliktit të pretenduar ndërmjet listës së hapur dhe kuotës gjinore. Arsyeja e vërtetë mund të jetë rritja e disiplinës partiake me qëllim të uljes së kundërshtimit ndaj dialogut dhe masave të tjera jopopullore. Ndonëse dialogu është i rëndësishëm dhe Kosova duhet t'i përmbushë obligimet ndërkombëtare që ajo ka marrë përsipër, nuk do të thotë që këto duhet të sakrifikojnë demokracinë e sapolindur.

Që listat e hapura të bëhen më kuptimplota, Kosova duhet të nxisë një valë të re intensive reformash. D4D dhe pjesa më e madhe e shoqërisë civile në mënyrë konsistente kanë avokuar (a) për shtatë zona zgjedhore, (b) që të zhbëhet tendenca që i pari në listë të zgjidhet automatikisht, (c) të ruhen listat e hapura dhe kuota gjinore, (d) të ulet pragu zgjedhor, dhe (e) të futet një mekanizëm kompensimi për të siguruar që zonat zgjedhore të mos rezultojnë me efekt mazhoritar (që do të shkeljet parimin e proporcionalitetit të paraparë me kushtetutë).

Për vitet 2015 dhe 2016, Kosova duhet të synojë që ta përmirësojë (a) procesin zgjedhor nëpërmjet përfshirjes së pjesës dërmuese të akteve nënligjore në një kod zgjedhor, (b) cilësinë e pjesëmarrjes dhe të përfaqësimit përmes rishikimit të sistemit zgjedhor (zonat zgjedhore dhe fletëvotimet me një shenjim), dhe (c) të rregullojë transparencën financiare të partive (përfshirë donacionet private).



## Elektorati dhe pjesëmarrja në votime

Njëri nga aspektet më të rëndësishme të procesit të zgjedhjeve është saktësia dhe përfshirja e listës së votuesve, pjesëmarrja në votime, fletëvotimet me postë, ato me kusht dhe shkalla e fletëvotimeve të pavlefshme.

### Lista e votuesve

Elektorati dhe ndryshimi vjetor			
2000	913.179	36,9%	Regjistrimi i serbëve të Kosovës dhe Diasporës
2001	1.249.987		
2002	1.320.481		
2004	1.412.680		
2007	1.567.690		
2009	1.563.741	-0,1%	Pastrimi i pare
2010	1.632.276	4,4%	Shumë më i lartë se norma e lindjeve
2013	1.792.913	3,3%	
2014	1.799.023	0,3%	Pastrimi i dytë
mesatarja e 13 viteve		3,4%	me përjashtim të vitit 2000

Në zgjedhjet e para të pas luftës, Kosova kishte më pak se një milion votues, dukshëm më pak se popullsia e para-luftës. Shumë prej banorëve të Kosovës nuk ishin kthyer pas luftës, ndërsa serbët refuzonin të regjistroheshin. Rritja e stërmadhe e listës së votuesve (LV) (me 37%, përkatësisht 5,6% në dy vitet pasuese) mund të shpjegohet vetëm me regjistrimin e shpejtë të diasporës së Kosovës, kthimin e të zhvendosurve dhe klimën e përmirësuar mes serbëve të Kosovës.

Përveç dy viteve të para, shtimi vjetor i listës së votuesve sillet nga 3,3% deri 4,4%, që është dukshëm më i lartë se që mund të shpjegohet me trendet demografike. Një vlerësim i përafërt rezulton se rreth 30.000 kosovarë mbushin 18 vjet çdo vit, ndërsa rreth 10.000 vdesin në vit. Shifra neto prej 20.000 mund të shpjegohet vetëm me rritjen mesatare prej 1,3% në vit. Në përgjithësi, mes viteve 2001 dhe 2014 (periudhë të cilën ne ia atribuojmë shtimit natyror dhe jo për shkak të regjistrimit të diasporës ose të serbëve të zhvendosur), lista është rritur me 3,4% në vit, rreth tre herë më shpejt se sa që shpjegohet me shtimin natyror. Nëse përqindjet shndërrohen në numra, lista është rritur me rreth 550.000 emra, ndërsa ajo do të duhej të ishte rritur për 216.000 emra.

Rreth një e treta e rritjes së dyshimtë është për shkak të mosheqjes nga lista e emrave të personave të vdekur. Është interesante se disa emra (kryesisht në vitin 2009) ishin hequr nga listat e votuesve por jo edhe nga regjistri civil. Meqë me ligj kërkohet që para çdo palë zgjedhje të përdoret regjistri i fundit civil, emrat që një herë ishin pastruar nga lista, sërish u gjenden në listën e votuesve në vitet e mëvonshme. Analistët shpesh përmendnin shembullin e Presidentit Rugova, emri i të cilit gjendej në LV me vite të tëra pas vdekjes së tij.


Banorë sipas regjistrimit të përgjithshëm	1.739.825*
Të mitur sipas regjistrimit të përgjithshëm	592.046
Banorë - të mitur = Votues real	1.147.779
Lista e votuesve (LV)	1.799.023
<b>LV - Votues real = jashtë vendit ose të vdekur</b>	<b>651.244</b>
*duke përjashtuar komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicën Veriore	

Lista e votuesve në të vërtetë ishte pastruar, me siguri si rezultat i punës së një grupi të përbashkët punues me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në vitin 2014, lista e

votuesve ishte më e madhe se në vitin 2013 për vetëm 0,3%. Në vitin 2009 ishte bërë pastrimi i parë i listës së votuesve, gjë që kishte rezultuar me një listë më të vogël krahasuar me atë të vitit 2007.

Një mënyrë tjetër për të vlerësuar shkallën e saktësisë së listës së votuesve është krahasimi i saj me të dhënat nga regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i kryer në vitin 2011, ku thuhet se Kosova ka 1.739.825 banorë, prej të cilëve afër 600.000 janë të mitur.<sup>4</sup> Në ilustrimin e mëposhtëm përllogariten grupimet e votuesve në bazë të moshës dhe të vendit të banimit (regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë jep një fotografi të çastit për sa u përket banorëve rezidentë të të gjitha moshave në Kosovë, krahasuar me LV ku janë të hequr të miturit, por janë të përfshirë kosovarët që jetojnë jashtë vendit). Nga zbritja e numrit të të miturve nga numri i përgjithshëm i banorëve mbeten rreth 1,15 milionë të rritur me të drejtë vote, dukshëm më pak se 1,8 milionë kosovarë me të drejtë vote që janë në LV.

Kosovarët që jetojnë jashtë vendit gëzojnë të drejtën ligjore për të votuar dhe kjo duhet të ruhet. Kosova ka një diasporë masive dhe është prioritet që ajo të mbahet lidhur ngushtë me vendin, ndonëse shifra e ulët e pjesëmarrjes së tyre nuk flasin në favor të kësaj. Gjersa e drejta e tyre e votimit nuk është problem, çështja që emrat e tyre të figurojnë në të njëjtën listë sikurse e të gjithë votuesve paraqet një problem. Duke qenë se ka procesi i votimit lë mjaft për të dëshiruar, rreth një/e treta e listës së votuesve potencialisht mund të keqpërdoret nga të tjerët, duke votuar në emër të atyre që janë jashtë vendit. Ilustrimi i mëposhtëm paraqet në mënyrë vizuale përllogaritetet tona se sa kosovarë janë të mitur, sa prej tyre jetojnë jashtë vendit, dhe sa banorë rezidentë mbeten me të drejtë ligjore për të votuar.



\*duke përjashtuar komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicën Veriore.

Mospërputhjet e listës votuese janë studiuar edhe më parë nga D4D përmes një auditi derë më derë me anë të të cilit krahasohej lista e votuesve në Kaçanik me banorët rezidentë realë. Studimi<sup>5</sup> konstatoi se vetëm rreth 60% e emrave në listën e votuesve gjendeshin në të njëjtat zona, gjersa pjesa tjetër ose ishin jashtë vendit (19%), të vdekur (3%), jetonin në ndonjë lokacion tjetër në Kosovë (11%), ose nuk kishte asnjë informatë për ta (7%).

### *Pjesëmarrja e vërtetë në votime*

Në vitin 2000, pjesa dërrmuese e kosovarëve (80%) dolën për të votuar, përderisa përqindja ra në 36% (në zgjedhjet për kuvendet komunale në vitin 2007), vetëm për t'u rikthyer në 46% në vitin 2013 (po ashtu në zgjedhje komunale). Grafiku më poshtë paraqet pjesëmarrjen në votime me numër të

votuesve (shtyllat) dhe përqindjen e listës së votuesve (vija).


Është me rëndësi të theksohet se numri i personave që vërtet kanë votuar dhe paraqitja e tyre si pjesë e elektoratit domosdoshmërisht nuk e përcjellin të njëjtin trend. Përqindjet do të duhej të lexoheshin me kujdes dhe mund të interpretohen vetëm duke pasur parasysh pasaktësitë në LV. Në vitin 2000, diaspora, serbët dhe shumë nga kosovarët e zhvendosur nuk ishin të regjistruar. Me rritjen e listës, këto kategori filluan t'i fryjnë radhët e gjoja jo-votuesve.

Duke shfrytëzuar përllogaritjet nga pjesa e mëparshme, ne mund të llogarisim përqindjen e personave që kanë votuar, por këtë herë si përqindje e kosovarëve që vërtetë banojnë në Kosovë. Mënyra e vetme për ta bërë këtë është që të shfrytëzohen të dhënat nga regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i vitit 2011, prej nga edhe zgjedhja jonë për t'i marrë të dhënat e zgjedhjeve të vitit 2010 si më të afërtat me të dhënat e vitit 2011. Zbritja e pjesëmarrjes së votuesve në votime nga numri i të rriturve që jetojnë në Kosovë (të paraqitur nga regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë), nxjerr pjesëmarrjen reale në votime prej 64,4%, që del se nuk ka krizë të daljes në zgjedhje, siç krijohet përshtypje nga shifrat zyrtare.

Të dhënat në grafikun më poshtë po ashtu mundësojnë identifikimin e një burimi potencial të mashtrimit. Fakti se janë mbajtur dy dhe tri palë zgjedhje në të njëjtën ditë (në vitin 2009, përkatësisht në vitin 2007) mundëson krahasimin e pjesëmarrjes në votime sipas llojit të zgjedhjeve. Për shkak që çdo votuesi i jepen tri fletëvotime njëherësh është e vështirë të besohet se janë hedhur 662.421 vota për zgjedhjet e përgjithshme në vitin 2007 dhe rreth 90.000 më pak për zgjedhjet komunale. Del se çdo i shtati votues ka hedhur vetëm një ose dy fletëvotime, por jo edhe të tretën, dhe nuk ka dëshmi se këto janë regjistruar si të dëmtuara apo janë flakur tutje. Këto raste janë jashtëzakonisht të rralla, që shpie në dyshimin.

Dalja në zgjedhje gjatë viteve 2000-2014

% gjithsejt:




Përceptimi i hierarkisë së rëndësisë së zgjedhjeve gjithashtu e përkrah dyshimin më lartë. Zgjedhjet e përgjithshme janë qartazi më të rëndësishmet dhe interesi për të “ngritur” pjesëmarrjen në votime është më i lartë (siç e tregon pjesëmarrja). Zgjedhjet e dyta për nga rëndësia janë ato për kryetarë të komunave, që pasohen nga zgjedhjet për kuvendet komunale që shihen si më së paku të rëndësishme, kështu me pjesëmarrje më të ulët, dhe me gjasë kjo është ‘pjesëmarrja’ reale në votime.

### *Votimi me postë dhe me kusht*

Një veçori interesante (si dhe e tepërt) e zgjedhjeve të Kosovës janë fletëvotimet me kusht, dtth. mundësia për të votuar në një lokacion tjetër nga ai i qendrës përkatëse të votimit, duke e përdorur zarfin e dyfishtë për të siguruar fshehtësinë. Pasaktësitë në listën e votuesve si dhe niveli i lartë i zhvendosjes së qytetarëve e ka bërë të domosdoshëm përdorimin e fletëvotimeve me kusht në mënyrë që mos t’u marrë të drejtën e votimit kosovarëve të cilët nuk gjejnë emrin në listë. Siç mund të shihet në tabelën e mëposhtme, rreth 3-5% të kosovarëve kanë shfrytëzuar fletëvotimet me kusht, ndërsa të tjerët prej 0,5% deri 3,5% kanë votuar me anë të postës.

Këto të dhëna janë ilustrim i përkryer se si KQZ ka vendosur të raportojë së bashku rezultatet e votimit me kusht dhe të votimit me postë. Këto shifra janë grumbulluar ndaras dhe është dashur një vendim i qëllimshëm për t’i shkrirë ato (shih vitet 2007-2014 më poshtë). Për më tepër, rezultatet janë kategorizuar sipas komunave vetëm për disa vite, e jo edhe për të tjerat. Kjo nuk mund të jetë rastësi pasi që KQZ ka mbledhur të dhënat veç e veç dhe duhet të ketë pasur arsye të fortë pse është vendosur që ato të publikohen të bashkuara.

Shkalla e pranueshmërisë së fletëvotimeve me kusht dhe me postë





		Numri i fletëvotimeve		Përqindja e fletëvotimeve	
		me kusht	me postë	me kusht	me postë
Parlament.	2001	57.969	27.601	7,21%	3,43%
K. Komunale	2002	34.898	6.957	4,91%	0,98%
Parlament.	2004	39.291	3.794	5,62%	0,54%
Parlament.	2007	33.791	6.233	5,11%	0,94%
K. Komunale	2009	23.377			3,47%
Parlament.	2010	24.867			3,36%
K. Komunale	2013	18.882			2,27%
Parlament.	2014	32.779			4,27%

Me rëndësi është të evidentohet edhe shkalla e refuzimit të fletëvotimeve me kusht, pasi që kjo tregon se, ose (a) përpjekjet për votim të votuesve pa zotësi juridike, ose (b) fletëvotimet e votuesve realë nga jashtë vendit janë refuzuar, sepse dikush tjetër tashmë kishte votuar personalisht në emër të tyre (shih grafikun në faqen tjetër).

Është interesante të shihen llojet e komunave që priren të kenë numër shumë të lartë të fletëvotimeve me kusht dhe të fletëvotimeve me postë. Prishtina ka kryesuar listën gjatë gjithë këtyre viteve, hiq zgjedhjet komunale të vitit 2013 kur ajo u tejkalua nga Prizreni (shih tabelën më poshtë). Komunitat me shumicë serbe kanë shënuar rezultate më të ulëta vazhdimisht.

Është e qartë se komunitat më të mëdha dhe ato urbane kanë sfida më serioze qoftë për shkak të madhësisë ose për shkak të shkallës së banorëve të zhvendosur. Megjithatë, trendet migruese zakonisht lëvizin nga komunitat më të vogla drejt atyre më të mëdha (dhe jo anasjelltas) dhe shumë banorët nuk e bartin zyrtarisht adresën e vendbanimit të tyre. Në këtë rast, shumë banorë të Prishtinës mund të kenë votuar për një komunë tjetër, gjë që do të shfaqte një shkallë të lartë të votimit me kusht në shumicën e komunave rurale. Shkalla e lartë e fletëvotimeve me kusht për Prishtinë shkon kundër logjikës dhe është e vështirë të shpjegohet. Kjo mund të jetë

një tregues i mashtrimit për shkak të shtytjes që komunat më të mëdha janë më të rëndësishme për t'i fituar.

Fletëvotimet me kusht			
Vitet e zgjedhjeve		Më e ulëta	Më e larta
Parlamentare	2001	Zveçan (0,18%)	Prishtinë (12,5%)
Kuvende komunale	2002	Zveçan (0,48%)	Prishtinë (12,7%)
Parlamentare	2004	Zubin Potok (0,05%)	Prishtinë (16,2%)
Parlamentare	2007	Novobërdë (0,04%)	Prishtinë (12,7%)
Kuvende komunale	2009	Zveçan (0,004%)	Prishtinë (12,8%)
Parlamentare	2010	Junik (0,14%)	Prishtinë (17,5%)
Kuvende komunale	2013	Klllokot (0,10%)	Prizren (13,1%)
Parlamentare	2014	Zubin Potok (0,08%)	Prishtinë (18,86%)

### *Votat e pavlefshme*

Shkalla e fletëvotimeve të pavlefshme është matës relevant nëse sistemi zgjedhor është i lehtë për t'u kuptuar nga të gjithë. Shkalla e lartë e fletëvotimeve të pavlefshme tregon ose shkallë të lartë të pakënaqësisë për shkak të një bojkoti aktiv, ose se sistemi është tepër i ndërlikuar të paktën për ata që nuk dinë shkrim e lexim, e që përkeqësohet tutje me edukimin joadekuat të votuesve.

Në vitin 2000, shkalla e fletëvotimeve të pavlefshme (duke përfshirë fletëvotimet e zbrazëta) ishte 2,6%, e që kishte rënë deri në 1,3% në vitet pasuese për dy arsye: (a) ishin mbyllur listat dhe (b) për katër palë zgjedhje votuesit mësuan se si të votonin. Kërkesa që të viheshin 23 shenja në vitin 2007 (tre palë zgjedhje në një ditë) dhe fakti se emrat nuk ishin në fletëvotim por në libërth të veçantë anash) ishte qartazi tepër e ndërlikuar për 8,6% votues, preferenca e të cilëve shkoi kot. Kundërshtarët e garës brenda-partiake i fajësuan listat e hapura për shkallën e lartë të fletëvotimeve të pavlefshme.

Ithtarët e demokracisë së brendshme partiake e fajësuan kombinimin e dy faktorëve: mungesën e zonave zgjedhore dhe faktin se tri tipare shtesë ishin sjellë njëkohësisht me mbajtjen e tre palë zgjedhjeve në të njëjtën ditë.


Në zgjedhjet komunale të viteve 2009 dhe 2013 u regjistrua shkallë edhe më e lartë e fletëvotimeve të pavlefshme, 10,1%, përkatësisht 10,2% – efektivisht duke zhvlerësuar çdo të dhjetën votë. Është lehtë të konkludohet se duhet

fajësuar dizajni i fletëvotimit, sepse për zgjedhjet për kryetarë të komunave (të mbajtura njëkohësisht) ishin vetëm 2,7% fletëvotime të pavlefshme (nga ky vit, statistikat përfshijnë edhe fletëvotimet e dëmtuara).

Në vitin 2007, zgjedhja e dhjetë emrave më të pëlqyer (më të preferuar) u reduktua në pesë dhe lakorja e të mësuarit do të duhej ta kishte zvogëluar numrin e fletëvotimeve të pavlefshme. Është për t'u habitur se pse shkalla e tyre nuk ishte zvogëluar, gjë që ngre dyshime për një mashtrim të mundshëm – se bërja e pavlefshme e fletëvotimeve mund të jetë shfrytëzuar si teknikë për të zhvlerësuar rezultatet gjatë numërimit.

Shkalla e fletëvotimeve të pavlefshme në zgjedhjet parlamentare të përzgjedhura	
Estonia (2015)	0,6%
Mbretëria e Bashkuar (2010)	1,03%
Shqipëria (2013)	1,8%
Greqia (2015)	2,3%
Maqedonia (IRJM) (2011)	2,7%
Shqipëria (2009)	2,9%
Bullgaria (2014)	5,1%
Belgjika (2014)	5,7%
Bosnja dhe Hercegovina (2014)	8,7%
Iraku (2014)	13,7%
Algjeria (2007)	14,4%
* Burimi: International IDEA	

Përqindja e fletëvotimeve të dëmtuara, zbrazëta dhe të pavlefshme



Vitet e zgjedhjeve		Fletëvotimet e pavlefshme		
		Gjithsej	Më e ulëta	Më e larta
Kuvende komunale	2000	3,4%	Istog (2,5%)	Fushë Kosovë (9,7%)
Parlamentare	2001	1,5%	Deçan (0,9%)	Podujevë (9,3%)
Kuvende komunale	2002	1,2%	Deçan (0,8%)	Dragash (3,4%)
Parlamentare	2004	1,0%	Deçan (0,6%)	Zveçan (35,8%)
Parlamentare	2007*	5,3%	Leposaviq (0,9%)	Ferizaj (7,7%)
Kuvende komunale	2009	7,8%	Leposaviq (3,5%)	Ferizaj (11,7%)
Kryetar Komune	2009	1,6%	Kllokot (0,9%)	Zveçan (17,9%)
Parlamentare	2010	3,6%	Ferizaj (1,5%)	Ranillug (8,5%)
Kuvende komunale	2013	8,5%	Mamushë (4,7%)	Glllogovc (11,9%)
Kryetar Komune	2013	1,9%	Junik (0,7%)	Zveçan (5,8%)
Parlamentare	2014	4,0%	Mamushë (2,6%)	Hani i Elezit (7,6%)

\*KQZ-ja nuk ka raportuar fletëvotime të zbrazëta në Zgjedhjet për Kryetarë të Komunave dhe Zgjedhjet për Kuvendet Komunale

Në tabelën më lartë paraqiten komunitet me shkallën më të ulët dhe më të lartë të fletëvotimeve të pavlefshme. Përveç fletëvotimeve të pavlefshme, është me rëndësi t'u kushtohet vëmendje edhe fletëvotimeve të zbrazëta që raportohen ndaras nga viti 2001. Është interesante të vërehet dallimi i madh i fletëvotimeve të zbrazëta nëpër komuna. Po të ishte niveli i tyre e ngjashme, kjo do të ishte një shenjë e analfabetizmit. Pasi që shkalla e tyre ndryshon, ky është një argument shtesë se ka pasur dëmtime (dhe plotësime) të qëllimshme të fletëvotimeve gjatë numërimit nëpër komunitet ku rezultatet kanë qenë shumë të ngushta.

Grafiku në faqen e mëparshme paraqet shkallën e fletëvotimeve të zbrazëta, të dëmtuara dhe të pavlefshme për të gjitha zgjedhjet deri tani. Në tabelën e mëposhtme paraqiten komunitet me shkallën më të lartë dhe më të ulët të

fletëvotimeve të zbrazëta. Përqindja e lartë e fletëvotimeve të zbrazëta në komunat serbe me gjasë ka qenë rezultat i një qëndrimi politik refuzues ndaj institucioneve të Kosovës. Nivelet shumë të ulëta në zonat tjera mund të jenë shenjë se fletëvotimet e zbrazëta kishin ofruar një mundësi të lehtë për komisionerët që t'i plotësojnë ato gjatë numërimit (një trend që po ashtu ishte vërejtur edhe nga vëzhguesit).

Fletëvotimet e zbrazëta				
Vitet e zgjedhjeve		Gjithsej	Më e ulëta	Më e larta
Kuvende Komunale	2000	9.757	Deçan (0,9%)	Gjakovë (2,0%)
Parlamentare	2001	3.471	Prishtinë (0,3%)	Leposaviq (0,9%)
Kuvende Komunale	2002	3.186	Prishtinë (0,2%)	Podujevë (2,0%)
Parlamentare	2004	2.726	Suharekë (0,1%)	Obiliq (7,1%)
Parlamentare	2007*	21.980	Obiliq (1,0%)	Shtërpce (30,7%)
Kuvende Komunale	2009	13.324	Ranillug (0,2%)	Novobërdë (5,1%)
Kryetar Komune	2009	4.923	Skënderaj (0,2%)	Leposaviq (55,2%)
Parlamentare	2010	4.668	Ranillug (0,1%)	Leposaviq (5,7%)
Kuvende Komunale	2013	12.667	Junik (0,1%)	Ranillug (2,9%)
Kryetar Komune	2013	8.234	Junik (0,1%)	Zveçan (7,7%)
Parlamentare	2014	4.782	Hani i Elezit (0,2%)	Ranillug (3,4%)

\*KQZ-ja nuk ka raportuar fletëvotime të zbrazëta në Zgjedhjet për Kryetarë të Komunave dhe Zgjedhjet për Kuvendet Komunale

Shkalla e fletëvotimeve të dëmtuara po ashtu ndryshon nëpër komuna. Për shembull, në Ferizaj në vitin 2009 është shënuar një shkallë jashtëzakonisht e lartë e fletëvotimeve të dëmtuara, qartazi rezultat i një përpjekje të organizuar. Se fletëvotimet e dëmtuara janë kryesisht rezultat i përpjekjeve të qëllimshme e të organizuara është se tri komunat me

rezultatet më të ngushta ishin rregullisht në krye të rangimit. Pasi që ne i kemi matur sipas përqindjes, madhësia e komunës nuk është relevante.

Fletëvotimet e dëmtuara				
Vitet e zgjedhjeve		Gjithsej	Më e ulëta	Më e larta
Kuvende komunale	2009	1.854	Shtërpçë (0,1%)	Prizren (9,9%)
Kryetar Komune	2009	2.560	Mamushë (0,04%)	Ferizaj (33,7%)
Parlamentare	2010	1.236	Leposaviq (0,08%)	Prishtinë (15,3%)
Kuvende komunale	2013	1.452	Partesh (0,07%)	Prishtinë (14,2%)
Kryetar Komune	2013	1.080	Kllokot (0,09%)	Prishtinë (9%)
Parlamentare	2014	1.899	Shtërpçe (0,05%)	Ferizaj (25,2%)


## Efekti në sjelljen votuese

Përzgjedhja e një sistemi zgjedhor ka për synim të përmbushë disa qëllime. Për shembull, kuota gjinore synon të përmirësojë përfaqësimin e grave, ndërsa listat e hapura kanë për synim të përmirësojnë llogaridhënien e drejtpërdrejtë të zyrtarëve të zgjedhur. Më poshtë, punimi analizon trendet e disa zgjedhjeve sa i përket kuotës, sa deputetë janë rizgjedhur, sa deputetë janë zgjedhur falë listave të hapura dhe si e përdorin votuesit votën preferenciale.

### *Kuota gjinore*

Pas futjes në përdorim të përfaqësimit prej 30% të grave në Kuvendin e Kosovës, ka pasur shumë debate lidhur me atë nëse përfaqësimi është simbolik apo substancial. D4D i ka shqyrtuar këto modele duke u bazuar në rezultatet e zgjedhjeve dhe në votën individuale që kanë fituar kandidatët. Grafiku më poshtë paraqet modelet e përfaqësimit gjinor në tre mandatet e fundit parlamentare.

Gjithsej gra të zgjedhura si deputete (për tre mandate me lista të hapura)



Zgjedhjet e vitit 2007 tregojnë se mbi 40% (16 prej 37) të deputeteve gra në Kuvendin e Kosovës i kishin fituar




mandatet e tyre pa ndihmën e kuotës, gjë që është ngritur mbi 50% (20 prej 38) në vitin 2014.

Kuota ka bërë të mundur një përfaqësim gjinor më të mirë në parlament, por janë listat e hapura që kanë bërë të mundur që një numër i konsiderueshëm i burrave dhe grave të fuqishme t'i përfaqësojnë zgjedhësit e vet. Në afatgjatë, vetëm konkurrenca brenda dhe përgjatë vijave partiake do të krijojë atë lloj dinamike e cila e rizbulon llogaridhënien dhe përfaqësimin me kalimin e kohës.

Grafiku më poshtë krahason shkallën e meritokracisë në zgjedhjen e deputeteve gra, të paraqitura nëpër tabela sipas përkatësisë partiake. Në vitin 2007, PDK kishte 7 (prej 12) deputeteve gra të cilat ishin zgjedhur me votat e veta, e që nga atëherë ky numër ka rënë në 2 (sërish prej 12). LDK ka pasur 4-5 gra të fuqishme që janë zgjedhur duke ju falënderuar vetëm votave të tyre (mbi 50% nga totali prej 8-9). Vetëvendosje ka pesë deputete gra, tri prej tyre janë zgjedhur falë votuesve të tyre (ndërsa të tjerat falë kuotës). Partitë më të vogla kanë performuar më mirë në mënyrë të vazhdueshme ku gati të gjitha gratë kishin grumbulluar vota të mjaftueshme për t'u zgjedhur. Të katër deputetet serbe dhe dy nga komunitetet tjera janë zgjedhur falë votës së tyre dhe kuota nuk ishte vënë në lëvizja fare.

Në vitin 2007, për çdo 3 meshkuj kanë votuar vetëm 2 gra. Viteve të fundit, ky dallim është ngushtuar por partitë duhet akoma të kenë si prioritet që të fitojnë vëmendjen e votuesve femra, të angazhohen për çështjet të cilat i preokupojnë ato, të inkurajojnë kandidatet popullore që të garojnë, në mënyrë që të përmirësojnë performancën e tyre të përgjithshme në zgjedhjet e ardhshme.


Cilat parti kanë pasur më shumë gra të suksesshme? (për tre mandatet me lista të hapura)



## Listat e hapura

Hapja e sistemit zgjedhor për kandidatë të veçantë (ku nuk votohet vetëm për partinë) nxit llogaridhënien dhe marrëdhëniet e drejtpërdrejta me zgjedhësit. Andaj është me rëndësi të matet se sa deputetë po e tejkalojnë pozitën e tyre në listë, siç u caktohet atyre nga partia dhe sa sosh po zgjidhen aty ku sistemi me listë të mbyllur do t'i linte prapa. Shifrat më poshtë tregojnë se një numër gjithnjë në rritje i deputetëve(eve) i kapërcejnë rangjet dhe zgjidhen vetëm falë listës së hapur. Rreth 60% e deputetëve do të zgjidheshin edhe me listat e mbyllura.


A janë zgjedhur deputetët falë **votës së tyre** ose falë **pozicionit në listat**?



Siç ndodh me garën gjinore, një kategorizim sipas partisë e bën të mundur rangimin e partive sipas shkallës së deputetëve meritore që zgjidhen përkundër pozitës inferiore në listë. Në PDK, 24% (9 prej 37) të deputetëve i tejkaluan kolegët e tyre që kishin pozitë më të mirë në listë, që kulmoi me 53% në vitin 2013. LDK po ashtu shënoi një rritje prej

28% në 37%, që kryesohej vetëm nga AAK (ngritja më e lartë nga 10% në vitin 2007 deri në 64% në vitin 2014) dhe JSL (67%). Një proces i brendshëm duket se e ka kursyer VV, ku vetëm 25% e deputetëve fituan mjaftueshëm vota për t'u zgjedhur përkundër numrit garues.


Më shumë fitues nga listat e hapura?



## Vota preferenciale

Njëra nga veçoritë e sistemit zgjedhor të Kosovës ka qenë vota preferenciale, d.m.th., mundësia që të shënjohej 5 (në vitin 2010 dhe 2014) ose 10 kandidatë (në vitin 2007) të së njëjtës parti. Krahasimi i numrit të shënjimeve që një votues mesatar ka bërë ndihmon në identifikimin e trendeve të mundshme dalluese. Duke qenë se një votues mund të shënjojte 10 kandidatë në vitin 2007, votuesit e PDK kishin shënjuar një mesatare prej 6,4 emrash, pasuar nga LDD me 6,3. Mobilizimi duket të ketë qenë më i lartë në vitin 2010, kur votuesit e PDK shënjuan 4,5 emra (nga 5 të mundshme), pasuar nga LDK me 4,2 ndërsa VV ishte në fund me 4 emra si zgjedhje. Kjo radhitje e partive në masë të madhe përputhet me numrin e komisionerëve që ka pasur në terren secila parti – PDK dhe LDK kishin numrin më të madh, ndërsa VV nuk kishte komisionerë duke qenë se ishte një parti e re. Në vitin 2014, kjo shkallë ka pasur rritje në mesin e të gjitha partive të tjera, ndonëse është e pamundur të thuhet nëse kjo varej nga mobilizimi i votuesve të tyre apo i komisionerëve të tyre.

Shënjjimet mesatare të bëra në fletëvotim



## Si bëhet zgjedhja?

Pasi që listat e hapura dhe zgjedhjet preferenciale paraqesin akoma risi, është me rëndësi të matet se si kosovarët vendosin se cilët emra t'i shënjojnë. Ne e kemi parashtruar këtë pyetje në dy raunde të anketës sonë, e krahasuar në tabelën më poshtë.

Kur keni votuar për partinë, për cilët kandidatë keni votuar?		
Anketa	Tetor 2012	Qershor 2014
Zgjedhjet lokale	2009	2013
<b>Rënie</b>		
Pesë emrat e parë	23%	11%
Afër liderit	12%	6%
Të dëshmuar profesionalisht	36%	31%
Të dëshmuar gjatë luftës	6%	3%
<b>Rritje</b>		
Nga qyteti im	11%	22%
Të gjinisë time	0%	2%
E njoh personalisht	7%	13%
Nuk e di/refuzoj	4%	5%
Nuk kam votuar	1%	7%

Respondentët e të dy anketave anonin kryesisht për kandidatët “profesionalisht të dëshmuar” dhe mund të ketë edhe arsye psikologjike se pse shumica e respondentëve zgjedhin këtë opsion. Është pozitive se pjesa e votuesve që i kanë shënjuar “shpejt 5 emra” është zvogëluar. Votuesit kanë filluar të votojnë më shumë për njerëzit që ata i njohin personalisht (13%) ose për ata që janë nga qyteti i tyre (22%), duke e mënjanuar mbështetjen e tyre për kandidatët afër liderit të partisë (6%).

## Pesha e lidërshiptit

Liderët e partive kryesore politike në Kosovë kanë ndikim të pafund në linjat më të ulëta të partisë dhe ata me të madhe shihen si arsyeja kryesore për shkallën e mbështetjes në mesin e elektoratit – prej nga rrjedh edhe vlerësimi se këto

janë parti lideriste.

Mbështetja për një lider politik mund të matet në mënyra të ndryshme, por në këtë kapitull masim popullaritetin e tyre në mesin e votuesve të vetë partisë së tyre – numri i votave që kanë fituar në krahasim me votat që ka marrë partia e tyre. Gjatë tri zgjedhjeve të kaluara, liderët e katër partive kryesore (PDK, LDK, VV dhe AAK), kanë marrë më shumë se gjysmën e votave që kanë shkuar për partinë, siç shihet nga përlllogaritjet tona bazuar në të dhënat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).


Çdo i dyti (50%) votues i LDK-së në vitin 2007, në mesin e pesë kandidatëve të kësaj partie e ka shënjuar edhe Fatmir Sejdiun, gjë që u rrit në 75% në vitin 2010 kur Isa Mustafa e mori drejtimin e partisë. Duke pasur parasysh besimin e partive që kanë në qendër liderin, Mustafa ishte lideri i vetëm i cili nuk e ka themeluar partinë dhe prapëseprapë doli më mirë se të gjithë liderët e tjerë më 2010. Por Mustafa nuk ia doli ta bëjë aktin e njëjtë në vitin 2014, kur ai mori vetëm 66% të votave të LDK, që do të thotë se çdo i treti votues i LDK nuk e ka shënjuar Isa Mustafën si njërin nga pesë kandidatët më të preferuar në LDK.

Pozita e Hashim Thaçit si kreu i PDK-së, që nga themelimi i partisë nuk e ka dobësuar autoritetin e tij në mesin e elektoratit të partisë. Përkundrazi, nga pozita prej vetëm 54% (vetëm 3% më mirë se Fatmir Sejdiu) në vitin 2007, ai e ka konsoliduar përkrahjen e votuesve të PDK dhe në zgjedhjet e fundit ai ka marrë 75% të votave të partisë, më shumë se çdo lider tjetër.

Ramush Haradinaj po ashtu ka rritur ndikimin e tij në mesin e votuesve të AAK-së, nga 64% në vitin 2007 në 72% në vitin 2014. Lidershipi i Albin Kurtit në Vetëvendosje është i lartë por me një trend të lehtë në rënie, gjë që mund të jetë konsistent me qëndrimin e kësaj lëvizje se ata udhëhiqen nga ideja dhe jo nga një udhëheqës i përjetshëm.



Popullariteti i liderëve në mesin e adhuruesve të partisë së tyre




## Marrëdhënia me politikën

Pjesa e mbetur e këtij punimi krahason rezultatet e tri anketave të zhvilluara mes viteve 2012 dhe 2015. Shkalla në të cilën qytetarët marrin pjesë në çështjet publike dhe se si ata kërkojnë mënyra për të ndikuar në politika janë sfidat kyçe për ta konsoliduar demokracinë. Votimi është forma kryesore e pjesëmarrjes demokratike dhe është me rëndësi për të hulumtuar se si përvoja e votimit dhe marrëdhënia me politikën evoluojnë me kalimin e kohës. Kjo pjesë e punimit analizon të gjeturat e anketës sa u përket kontakteve me përfaqësuesit, anëtarësinë e partisë/përkatësinë partiake, afërsinë me një parti, dhe për atë se si vendosin votuesit sa i përket zgjedhjes së tyre.

### Kontakti me përfaqësuesit

Njëri nga kriteret kryesore që e mat raportin me politikën është shpeshësia e kontakteve me zyrtarët e zgjedhur në dymbëdhjetë muajt e fundit.

Kanë pasur kontakte në dymbëdhjetë muajt e fundit me..



Në vitin 2012, vetëm një nga dhjetë votues kishte kontakte me kryetarin e komunës dhe gjysma e kësaj me ndonjë deputet të parlamentit. Se zgjedhjet e vitit 2014 ishin zgjedhje


shumë të rëndësishme vërtetohet me faktin se zyrtarët e zgjedhur e kanë trefishuar kontaktin e tyre me votuesit. Fatkeqësisht, me përfundimin e zgjedhjeve, bie edhe kontakti me votues (siç ka rënë në vitin 2015), edhe pse më i lartë se në vitin 2012.

Gratë kanë pasur kontakte më të pakta me zyrtarët e zgjedhur. Në vitin 2012, 13% e burrave e kishin takuar kryetarin e komunës, një privilegj i ofruar vetëm për 6% të grave. Trendi është edhe më i ulët për këshilltarët komunalë dhe deputetët e parlamentit, paradoksisht pasi që nuk kishte kryetare gra të komunave në vitin 2012, gjersa 30% e anëtarëve të secilit organ ligjvënës përbëhej nga gratë. Përmirësimet në vitin 2014 dhe 2015 e kanë zvogëluar konsiderueshëm hendekun. Ndërsa vetëm 2% e grave e kishin mundësinë të takonin një deputet(e) në vitin 2012 (rreth pesë herë më pak se burrat), në vitin 2015 u ngrit në 10%, dy të tretat e përqindjes së burrave (15%). Përqindja e grave që e kanë takuar një zyrtar publik në dymbëdhjetë muajt e fundit është rritur, por jo në mesin e shtëpiakeve. Një shqyrtim më i detajuar është paraqitur në grafikun në faqen tjetër.

Është shënuar rritje edhe në mesin e studentëve, të rinjve dhe atyre të arsimuar mirë. Respondentët të cilët punojnë kanë prirje të takohen me zyrtarët publik më shpesh. Ata të cilët punojnë në institucionet publike kanë dy herë më shumë gjasa të kenë takuar një zyrtar publik (rreth një e treta) krahasuar me ata të që janë të punësuar në sektorin privat.

Në vitin 2012, votuesit e LDK kishin më pak të ngjarë të kishin takuar ndonjë deputet, këshilltar ose kryetar komune. Në vitin 2015, respondentët e LDK i kishin përmirësuar kontaktet e tyre me kryetarët e komunave, por qëndronin nën mesatare në kontaktet me deputetët dhe këshilltarët. PDK është pasqyrë e imazhit të LDK-së – në vitin 2012 ata kishin më shumë të ngjarë të kenë takuar të gjitha (të tri) kategoritë, dhe në vitin 2015, kontaktet e tyre me kryetarët e komunave u përkeqësuan, por u përmirësuan për dy kategoritë e tjera.

A keni takuar një ... gjatë 12 muajve të fundit (sipas gjinisë)




Në vitin 2012, votuesit e AAK kanë pasur më pak mundësi të takojnë një deputet, e më shumë të takojnë një këshilltar ose kryetar komune. Kjo gjë është përkeqësuar për të gjitha kategoritë në vitin 2014, dhe në vitin 2015 këshilltarët e saj duket se kanë bërë një përpjekje shtesë, siç vihet në dukje nga anketa. Simpatizuesit e VV-së kanë qenë të ekspozuar ndaj deputetëve, por më pak ndaj kryetarëve të komunave dhe këshilltarëve, gjë që janë barazuar në dy vitet e fundit.

### Anëtarësimi dhe afërsia me parti

Anëtarësia e partisë është diagnozë kryesore e shëndetit të demokracisë. Përqindja e kosovarëve të cilët janë besnik ndaj partive politike është rritur mes viteve 2012 dhe 2014, vetëm për të rënë në nivele dramatikisht të ulëta përsëri në vitin 2015. Grafiku më poshtë paraqet shkallën e kosovarëve të cilët deklarojnë se janë anëtarë të një partie politike, që asnjëherë nuk kanë qenë anëtarë, ose që kanë qenë anëtarë në të kaluarën.

A jeni anëtar i ndonjë partie politike?




Anëtarësia e partisë ndikohet nga një sërë faktorësh, mes

tjerash edhe nga shkollimi. Individët me arsim të lartë kanë dyfish më shumë gjasa të jenë anëtarë të ndonjë partie krahasuar me ata me shkollim të mesëm, ndërsa respondentët me më pak se shkollimi fillor kanë më së paku gjasa. Me më së paku gjasë për të qenë anëtarë të një partie politike është segmenti me më së paku shkollim si dhe moshat 18-24 vjeç.


Simpatizantët më entuziast të partive janë 35-44 vjeçarët të cilët pasohen nga 25-34 vjeçarët. Në vitin 2012, 90% e grave asnjëherë nuk kishin qenë anëtare të ndonjë partie, gjë që ka rënë në 80% në vitin 2015, gjersa anëtarësimi i grave është rritur nga 2% në 8%. Të ardhurat janë një përcaktues i fuqishëm i anëtarësimit në parti, prej kësaj rreth gjysma e respondentëve të cilët fitojnë më shumë se 750 Euro janë të anëtarësuar në ndonjë parti, me një trend të rënies në vetëm mbi 20% për ata që fitojnë më pak se 150 Euro.

Simpatizantët e LDK-së kanë pasur dozë më të lartë të anëtarësimit në vitin 2012. Në vitin 2014, kur ka pasur një valë të anëtarësimeve nëpër parti përgjatë spektrit politik, PDK e ka tejkaluar LDK dhe deri më sot, simpatizantët e saj kanë më shumë të ngjarë të kenë anëtarësim formal. Në vitin 2015, rreth 15% të votuesve të PDK janë anëtarë të kësaj partie, dhe kjo shifër qëndron në 10% për LDK dhe 9% për VV. Si rrjedhojë e kësaj, LDK merr më shumë vota nga ata të cilët asnjëherë nuk kanë qenë të anëtarësuar në ndonjë parti. Rreth 80% e respondentëve të cilët do të votonin për LDK nuk janë anëtarë të partisë. Rreth gjysma e simpatizantëve të VV më parë kanë qenë anëtarë të ndonjë partie tjetër.

Afërsia me ndonjë parti politike



Afërsia me ndonjë parti politike (sipas punësimit)





Ngjashëm me anëtarësimin, afërsia me partitë politike po ashtu është zbehur (shih grafikun në faqen e mësipërme). Shkalla e kosovarëve të cilët ndihen shumë të afërt me ndonjë parti ka rënë nga 25% në 15%, që është një shenjë se shkalla e mbështetjes militante ka rënë. Rritja e pjesës së atyre që thonë se ndihen “disi të afërt” është një shenjë se afërsia pragmatike është rritur, por këta janë respondentët të cilët po ashtu priren ta ndërrojnë përkatësinë partiake. Shkalla e kosovarëve që nuk ndihen të afërt me politikën po ashtu është rritur, shenjë kjo e zhgënjimit në rritje me klasën politike në tërësi. Është interesante të vërehet se ka rënë përqindja e atyre që përgjigjen me ‘nuk e di’.

Respondentët e punësuar (kryesisht të sektorit publik por edhe në sektorin privat) ka më shumë të ngjarë të jenë anëtarë të partisë, të pasuar nga të papunët, ndërsa studentët, të pensionuarit dhe shtëpiaket kanë gjasa më të vogla. Dikush që është i papunë por që është në kërkim të punës ka tre herë më shumë gjasa t’i përkasë ndonjë partie, pasuar nga të papunët që nuk janë në kërkim të gjetjes së punës. Ngjashëm me anëtarësimin në parti, pyetja “sa të afërt ndjeheni me ndonjë parti” jep rezultate të ngjashme. Tre çereku i punëtorëve me orar jo të plotë ndihen shumë të afërt (22%) ose disi të afërt (53%) me ndonjë parti.

Një e treta e votuesve të PDK-së ndjeheshin shumë të afërt me partinë në vitin 2012 (më lartë se partive tjera), gjë që ra në një të pestën në vitin 2014 (në një shkallë me LDK-në). Kjo me të madhe është zëvendësuar me më shumë simpatizues të PDK-së të cilët ndjehen "disi të afërt" (nga 42% në 53%), por edhe nga votuesit që ndihen disi "jo të afërt" (nga 9% në 18%). Më pak se 30% e votuesve të LDK-së ndjeheshin shumë të afërt në vitin 2012, gjë që është zvogëluar në 21% në vitin 2014. Edhe shkalla e pakënaqësisë është rritur – shkalla e respondentëve që nuk janë ndjerë të afërt me partinë është rritur nga 21% në 32% nga viti 2012 në 2014. Trendi i Vetëvendosjes është i ngjashëm, ndonëse pak më i butë.

Vetëm 16% e atyre që do të votonin për VV janë deklaruar si simpatizantë flaktë, që ka mbetur e njëjtë në vitin 2014. Është shtuar numri i atyre të cilët thanë se janë disi të afërt, nga 37% në 46%. Shkalla e pakënaqësisë është rritur lehtë, nga 26% në 34%. Partitë e tjera, të para së bashku kanë trende të ngjashme.

Shkalla e meshkujve që janë përgjigjur si shumë të afërt ka rënë nga 30% në 19%, dhe në mesin e femrave kjo gjë është edhe më e mprehtë, nga 21% në 11%. Shkalla e rritjes në mesin e atyre "disi të afërt" ishte e njëjtë si te meshkujt ashtu edhe te gratë. Pjesa e femrave dhe e meshkujve që thanë se ata 'nuk janë të afërt' është e njëjtë (18%), por ka më shumë femra që janë përgjigjur me "disi jo të afërta".

Afërsia me politikën ka rënë për të gjitha nivelet e shkollimit, por më së shumti ka rënë tek respondentët me më së paku shkollim. Të rinjtë dhe të moshuarit e kanë shtuar distancën ndaj partive politike. Studentët dhe shtëpiaket janë në fund të grupit ku vetëm 14%, përkatësisht 3% e tyre ndjehen të afërt me politikën.

## Trendet në votim

Kjo pjesë e punimit përqendrohet në numrin e partive që kanë garuar nëpër vite, performancën e partive, të kombinuar me rezultatet e një ankete të opinionit publik të cilat janë të paraqitura në tabela dhe të kros-tabuluara me një sere tiparesh demografike. Këto pasohen me një analizë se në çfarë mase kosovarët e rëndomtë kanë ndërruar partinë e tyre të preferuar me kalimin e kohës, cila parti do të ishte zgjedhja e tyre e dytë, si dhe shkalla të cilët ata i mbështesin liderët përgjatë vijave partiake.

	2001	2004	2007	2010	2014
	Zgjedhjet Parlamentare				
Partitë politike	23	27	24	28	26
Shqiptare	17	16	10	7	7
Serbe	1	2	8	8	4
Turke	1	1	1	2	2
RAE	2	3	2	4	6
Boshnjake	2	4	2	5	6
Gorane	0	1	1	2	1
Iniciativa qytetare	0	1	0	1	3
Kandidatë të pavarur	3	5	1	0	1

Numri i partive të cilat garojnë në zgjedhje është i rëndësishëm dhe është tregues i shkallës së konsolidimit të skenës partiake. Gjatë fazave të hershme të transicionit në çdo vend garojnë një numër i madh i partive politike, dhe ky numër bie me kalimin e kohës. Për shembull, ishin 17 parti që përfaqësonin shqiptarët e Kosovës e që garonin në zgjedhjet e vitit 2001, për të rënë vetëm në 7 sosh në vitin 2014. Numri i partive serbe kulmoi në 8 ndërmjet viteve 2007 dhe 2008 ndërkaq ka rënë në katër sosh në vitin 2014.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten rezultatet e votave që partitë kanë fituar në secilin cikël zgjedhor. Kjo tabelë dhe grafiku më poshtë (që paraqet numrin e ulëseve në parlament) ilustron fuqinë votuese me kalimin e kohës. LDK ka shënuar një rënie të ashpër dhe një ringjallje


modeste. PDK ka shënuar rritje graduale prej rreth 10% në katërmbëdhjetë vjet. Vetëvendosje ka shënuar një rritje prej 10% në katër vjet dhe numri i deputetëve të saj është rritur në 16. AAK e ka rritur numrin e deputetëve, por asnjëherë nuk e ka tejkaluar numrin prej 15 deputetësh.

	LDK	PDK	VV	AAK	P. e vogla shqiptare	Serbët	Tjerët
2000	398.872	187.046	-	53.037	28.135	-	11.544
2001	359.851	196.823	-	59.625	41.277	31.362	23.733
2002	320.918	207.012	-	61.824	45.273	38.252	22.686
2004	313.437	198.603	-	57.724	87.836	1.232	22.364
2007	129.410	195.058	-	54.209	44.578	1.564	17.013
2007	128.901	189.012	-	56.676	37.363	221	9.340
2007	146.211	194.817	-	60.450	38.793	2.908	19.162
2009	175.563	235.315	-	121.023	49.084	8.642	20.556
2009	151.771	200.148	-	95.066	29.050	7.184	10.684
2010	172.552	224.224	88.566	77.103	19.313	18.576	24.793
2013	191.362	202.498	60.995	104.877	46.283	47.775	24.371
2013	236.741	234.291	70.578	120.806	27.293	36.026	7.247
2014	184.323	221.809	98.514	69.686	37.508	38.034	33.056


PDK dhe LDK e kanë dominuar Kuvendin e Kosovës në pesëmbëdhjetë vitet e kaluara, edhe pse në vitin 2014 ata bashkërisht arritën të kontrollojnë një hise më të vogël se sa më parë. Për rreth gjysmën e kësaj periudhe, LDK dhe PDK paraqiten si opozitë ndaj njëra tjetrës ndërsa për gjysmën tjetër ato janë bashkuar me njëra tjetrën në koalicion, duke krijuar qeveri të koalicionit të madh.

Në një punim<sup>6</sup>, D4D ka argumentuar se partitë e Kosovës nuk do të duhej të konsolidoheshin përgjatë vijave të tri partive kryesore dhe se vendit i duhet një transformim i konsiderueshëm. Partitë do të duhej të marrin qëndrime të qarta në shumicën e çështjeve me rëndësi për publikun dhe me kalimin e kohës të zhvillojnë një konsekuencës në qëndrimet e tyre. Më poshtë, në këtë punim shqyrtohet trendi i secilës parti veç e veç.

Numri i deputetëve në Kuvend



PDK dhe qëndrueshmëria e votuesve të saj




PDK ka treguar një konsekuencë të qëndrueshme gjatë viteve. Ajo ka fituar zgjedhjet që nga viti 2007 kur për herë të parë fitoi pozitën e kryeministrit. Është me rëndësi të vihet në dukje se PDK kishte fituar pozitën e kryeministrit me më pak se 200.000 vota për shkak të daljes së përgjithshme të ulët në votime dhe të çarjes së LDK-së. Në zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet për kryetarë të komunave në vitin 2013, PDK e ruajti një pjesë stabile të elektoratit të saj, ndonëse nuk doli mirë në balotazh në zgjedhjet për kryetarë të komunave, kur ajo i humbi shumicën e komunave të mëdha kundrejt LDK-së.

Fitoret e PDK-së të viteve 2007 dhe 2010 janë kontestuar gjerësisht dhe fitorja e parë e PDK-së e pakontestuar vjen në vitin 2013 kur sjellja elektorale shënoi një përmirësim. Në 2014, PDK ka ruajtur në masë të madhe bazën e vet edhe duke krahasuar me rezultatet më të mira që ka shënuar ndonjëherë (2010). Ndonëse ajo doli si partia e parë më 2014, në bisedimet për koalicion ajo e humbi postin kryesor kundër LDK, që kishte një pozitë më të mirë negociuese për të formuar qeverinë.

LDK mban rekordin me 45 deputetë të Kuvendit që kishte fituar në vitin 2001. Akoma nën udhëheqjen karizmatike të Rugovës, LDK humbi një pjesë të mbështetjes së saj, por arriti të fitojë zgjedhjet në vitin 2004. Që nga humbja e liderit të saj, LDK ka pësuar nga mungesa e lidershit, pakënaqësitë e brendshme dhe bërrylat për pushtet, që e ka reduktuar LDK-në, nga 313.437 vota në vitin 2004, në 129.410 në vitin 2007, pak mbi një të tretën e madhësisë së dikurshme të saj, duke shënuar kështu rezultatin më të keq në historinë e saj. Ky moment shërbeu si ndryshim kryesor i pushtetit në vend, ku PDK merr pozitën prijëse me më shumë se 35 deputetë. Me variacione të vogla, trendi i njëjtë vazhdon deri më sot.

LDK – Rrëimi dhe rikthimi i pjesshëm






Një nga fraksionet të cilat u ndanë nga LDK (dhe më vonë u shkrinë me AAK) ishte LDD (Lidhja Demokratike e Dardanisë), e Nexhat Dacit, ish-zyrtari i LDK, i dyti në udhëheqje në LDK. AKR (Aleanca Kosova e Re), një parti e themeluar nga biznesmeni i suksesshëm Behgjet Pacolli, konsideronte që mund të merr një pjesë substanciale të votës së LDK-së. Edhe nëse mblidhen rezultatet e tri partive që kanë dalë nga vota e LDK-së, shumica e tyre nuk arrin rezultatet e LDK-së të vitit 2004, një tregues se çarja e saj rezultoi në më pak se shumën e pjesëve të saj – dhe se beteja për pushtet rezultoi me pakënaqësi të madhe në përgjithësi. Kjo pakënaqësi mund të vërehet edhe në pjesëmarrjen e përgjithshme të ulët në vitin 2007 (më e ulëta nga të gjitha vitet), tregues ky se pjesa më e madhe e votuesve të LDK kishin zgjedhur të mos votonin fare.

LDK arriti të bëjë një lloj rikthimi në vitin 2013 kur ajo ia doli t'i fitojë disa qytete kryesore, por e humbi kryeqytetin dhe dy komuna të tjera që i kishte nën kontroll. Fakti se LDK mbajti vetëm një komunë kur ajo ishte në pushtet është një tregues se kjo nuk ishte një erë e ndryshimit pro-LDK, por një votë kundër-PDK. Ky entuziazëm i joracional u kushtoi atyre në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014, të cilave ata iu qasën me një vetëbesim të tepruar.

Ëndrra e Ramush Haradinajt (dhe këmbëngulja e tij) që të shërbejë një mandat të plotë si kryeministër gradualisht po fashitet. Haradinaj ishte bërë kryeministër i Kosovës për tre muaj, por ishte detyruar të jepte dorëheqje për shkak të akuzave nga Tribunali Ndërkombëtar për Krime të Luftës në Hagë (TPNJ). Akuzat për krime të luftës patën një efekt të madh në organizimin politik të AAK-së. Partia asnjëherë nuk e fitoi mundësinë për t'u rritur përtej pikës kulmore prej rreth 70.000 votash. Haradinaj ishte liruar përkohësisht në vitin 2009, kur partia e tij politike kishte arritur rreth 100.000 vota në zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe në zgjedhjet lokale.


AAK



Në vitin 2010, Haradinaj ishte dërguar sërish në Hagë dhe AAK u rikthye prapë në performancën e saj të mëparshme. I liruar nga akuzat dhe i pranishëm në Kosovë ai i ndihmoi AAK që ta përsërisë suksesin e vitit 2009 në zgjedhjet e vitit 2013, por këtë herë kishte performuar më mirë në zgjedhjet për kuvendet komunale sesa në garën për kryetarë të komunave. Qëllimi i Haradinajt për të justifikuar humbjen e komunave me performancën e kandidatëve për kryetarë të komunave nuk ishte mbështetur në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014. Në vitin 2014, AAK edhe një herë u ishte kthyer rezultateve të saj tradicionale prej 70.000 votave.

Lëvizja Vetëvendosje është subjekti politik me trendin më pozitiv të rezultateve që mbështetet edhe me rezultatet e anketës së kohëve të fundit. Siç raportohet, imazhi i saj si lëvizje (paradoksale kjo pasi që ajo ka hyrë në garën politike), programi dhe ideologjia e saj konsistente i kanë dalluar ata nga subjektet e tjera politike. Për dallim nga të gjitha subjektet e tjera të krijuara rishtazi që kanë pasur rënie në zgjedhjet e dyta, LVV ia ka dalë të rritet me rreth 10.000 vota.

Entuziazmi i partive të reja?




Asnjëra nga partitë e reja nuk ishte me fat që të mbetej relevante në skenë për shumë gjatë. Grafiku më lartë e


dëshmon se ekziston një entuziazëm i mjaftueshëm për opsione të reja politike, por asnjë nga këto subjekte nuk ruajti energjinë me kalimin e kohës. Partia politike 'Ora' ishte subjekti i parë që shkundi skenën duke marrë 50.000 vota në vitin 2004, duke hyrë kështu në Kuvend. Në vitin 2004, vota ishte e shpërndarë më shumë se ndonjëherë më parë. Tre vjet më vonë, në vitin 2007, Ora nuk ia doli ta kalonte pragun për të hyrë në parlament. Dy liderët e tjerë të subjekteve të krijuara rishtazi ishin disi më me fat se Surroi. Behgjet Pacolli (AKR) dhe Nexhat Daci (LDD) krijuan subjektet e reja dhe fituan 50.000, përkatësisht 70.000 vota, të mjaftueshme këto për të hyrë në parlament. LDD e pësoi fatin e njëjtë sikurse ORA, duke mbetur jashtë parlamentit në zgjedhjet e dyta në vitin 2010. AKR pësoi një trend të ngjashëm në rënie, por ka mbetur politikisht aktive deri në ditët e sotme, kryesisht për shkak se ajo ka fituar postin e kryetarit të komunës në dy qytete kryesore.

Grafiku më poshtë paraqet rezultatet që kanë fituar partitë më të vogla shqiptare, përkrahja e të cilave ka rënë me gjasë për shkak të pragut. Rezultatet e zgjedhjeve janë një pasqyrim i qartë i pjesëmarrjes së serbëve në jetën institucionale të Kosovës (shih grafikun më poshtë në faqen e radhës). Serbët kanë votuar në nivel të kënaqshëm në vitet 2001-2002 në zgjedhjet e para të përgjithshme si dhe në zgjedhjet lokale të organizuara nga Administrata e Përkohshme e KB-ve (UNMIK). Beogradi ishte pajtuar me një pjesëmarrje të tillë dhe aprovimi i tyre mbetet thelbësor për pjesëmarrjen e serbëve në zgjedhje.


Partitë e vogla shqiptare



Votat e serbëve të Kosovës



Votat e komuniteteve të tjera (Boshnjak/Goranë, Turq, RAE)



Serbët kanë bojkotuar zgjedhjet nga vitet 2002 deri 2010, ku vetëm disa grupe lokale garonin në zgjedhje. Shkalla më e ulët e votimit të tyre u shënuar në vitin 2007, në prag të shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Pjesëmarrja u rrit në 18.000 në vitin 2010 kur ndikimi i Beogradit mbi partitë serbe në Kosovë ishte i ulët. Dalja rekorde e serbëve në zgjedhje ndodhi në zgjedhjet komunale të vitit 2013. Si rezultat i dialogut të Brukselit, Beogradi u bëri thirrje serbëve që të merrnin pjesë dhe për herë të parë që nga pavarësia e Kosovës, serbët e veriut dolën për të votuar. Mbi 47.000 serbë votuan në zgjedhjet për kuvendet komunale.

Për dallim nga komuniteti serb, komunitetet tjera kanë votuar në të gjitha zgjedhjet, dhe numri i partive që i përfaqësojnë ata është rritur. Komuniteti boshnjak dhe ai RAE (rom-ashkali-egjiptian) ia kanë dalë ta rrisin numrin e përgjithshëm të votave në mbi 10.000, përkatësisht 7.000. Komuniteti turk po ashtu ka ruajtur një bazë të qëndrueshme elektorale, të kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme nga një parti, e cila ka gëzuar mbështetjen e partisë në pushtet në Turqi.

Rezultatet e paraqitura më lartë janë mbështetur në krahasime të rezultateteve zyrtare, përderisa më poshtë pason analiza e përgjigjeve se për kë do të votonin respondentët nëse zgjedhjet do të mbaheshin këtë të dielë.

### *Trendi në të ardhmen*

Anketat e pranverës së hershme të vitit 2015 kanë treguar se dallimi ndërmjet tri partive kryesore është ngushtuar, e në të njëjtën kohë partitë më të vogla po pësojnë rënie dhe po ngecin prapa (shih grafikun në faqen tjetër). PDK ende prin, e pasuar nga LDK dhe VV, por dallimi i tyre prej 1-2% është brenda margjinës së gabimit. Krahasuar me anketat e viteve të mëparshme, përkrahja për PDK është zvogëluar ndjeshëm, ndërsa përkrahja për LDK po ashtu ka rënë konsiderueshëm, gjersa përkrahja për VV është rritur shumë shpejt. Përkrahja




për AAK po ashtu ka rënë, siç ka rënë edhe për partitë më të vogla.


Pasi që nuk janë planifikuar zgjedhje në të ardhmen e afërt dhe këto rezultate nuk pritet të kenë efekt të menjëhershëm, ne e kemi parashtruar pyetjen me synimin që ta kros-tabulojmë përkatësinë partiake me faktorë të ndryshëm demografikë që mund të shpjegojnë trendet aktuale. Kros-tabulimi sipas profesionit zbulon se punëtorët e sektorit publik e përkrahin PDK (mbi një e treta krahasuar me anketën e përgjithshme të PDK prej 28% për vitin 2014). Gati gjysma e pensionistëve votojnë për LDK (krahasuar me anketën e përgjithshme të LDK prej 25%). PDK dhe LDK kanë humbur joshjen/përkrahjen e tyre në mesin e më pak të arsimuarve dhe e kanë përmirësuar në mesin e atyre me arsim të lartë.

PDK ka pasur përkrahje më të lartë në mesin e grave në vitin 2012, që ka rënë me kalimin e kohës. LDK ka gëzuar përkrahje shumë të ulët në mesin e grave në vitin 2014, të cilën duket se e ka rikuperuar pjesërisht. Përkrahja për Vetëvendosjen në mesin e grave është rreth 3% më e lartë se në mesin e burrave. Po ashtu është me rëndësi të vërehet se pjesa e respondentëve të pavendosur është zvogëluar.


Nëse zgjedhjet do të mbaheshin këtë të diele, për kë do të votonit?




Nëse zgjedhjet do të mbaheshin këtë të diele, për kë do të votonit? (sipas gjinisë)




Nëse zgjedhjet do të mbaheshin këtë të diele, për kë do të votonit? (sipas nivelit të shkollimit)



Po ashtu është interesante të paraqiten rezultatet në tabela të shumëfishta krahasuese sipas grupeve të moshës. Grafiku i PDK-së për vitin 2015 është më i ulët se ai i vitit 2014 për të gjitha grupmoshat, përveç për ata ndërmjet 25-34 vjeç.




Anketa për LDK-në për vitin 2015 qëndron vetëm pak më dobët sesa ajo e vitit 2014 dhe vlen barabartë për të gjitha grupmoshat. Hendeku është më gjëri për grup-moshat ndërmjet 45-54 vjeç dhe duket se LDK e ka ndalur rënien e popullaritetit të saj në mesin e të rinjve.




Anketa për VV-në për vitin 2015 tregon një rritje për të gjitha grupmoshat përveç atyre 25-34 vjeç, grafiku i anasjelltë ndaj atij të PDK.

### VV



Grafiku i responentëve që do të votonin për AAK-në në vitin 2015 tregon rënie për të gjitha grupmoshat, ndërsa është i barabartë me pjesën e saj të vitit 2014 vetëm për grupmoshën 45-54 vjeç.

### AAK



Po ashtu është me rëndësi të përpiqemi ta dallojmë qartë se cilët votues e kanë ndërruar zgjedhjen e tyre dhe si e kanë bërë atë këtë.

### *Ndërrimi i zgjedhjes?*


Votuesit gjithnjë e më shumë po e ndërrojnë partinë e tyre të preferuar, në përputhje me rezultatet e anketës sa i përket anëtarësisë së partisë. Prej vitit 2007 deri në vitin 2010, gjysma e respondentëve e kanë ndërruar zgjedhjen e tyre sa i përket partisë. Rreth një e treta e kanë ndërruar prej vitit 2010 deri në 2013, mbase shenjë e konsolidimit gradual. Po ashtu prej vitit 2012 deri në vitin 2014, më shumë respodentë kanë thënë se ata e kanë ndërruar zgjedhjen e tyre krahasuar me dy vite më herët, shenjë kjo se vota e luhatshme po rritet dhe se numri i militantëve është duke rënë.

Përqindja e respodentëve që përgjigjet se ka votuar njësoj ka rënë. Klima politike qartazi po perceptohet si më e rëndë dhe ekziston një zhgënjim me klasën politike, duke gjykuar nga pjesa e madhe e respondentëve që janë përgjigjur me “nuk e di” ose që kanë refuzuar të përgjigjen.

---


#### **A ishte zgjedhja e juaj e partisë e njëjta si në zgjedhjet e mëparshme?**

---



Është me rëndësi të kryqëzohen rezultatet e ndryshimit të votës me veçori të ndryshme demografike për të zbuluar se cili është profili i votuesit që ndërron partitë më shpesh. Gratë (përfshirë amviset) formojnë grupin më të madh votues që ndërron votën dhe si i tillë përbën grupimin më të rëndësishëm elektoral për partitë që dëshirojnë ta ruajnë ose ta rrisin bazën e tyre elektorale. Në fillim të kësaj pjese vihet në dukje se partitë që e kanë përmirësuar pozitën e tyre në mesin e grave i kanë përmirësuar anketat e tyre të përgjithshme dhe anasjelltas.

E kanë ndërruar preferencën ndaj partisë (sipas grupmoshës)



Profesioni është po ashtu një përcaktues i fuqishëm nëse dikush e ndërron partinë e vet të preferuar. Pensionistët kanë më së paku të ngjarë ta ndërrojnë partinë, të pasuar nga shtëpiakët. Respodentët e papunë po ashtu ngurrojnë të ndryshojnë përzgjedhjen partiake, dhe kjo vlen sidomos për ata që janë në kërkim të një pune. Punëtorët në sektorin privat dhe studentët janë më së paku besnikë dhe janë të prirë më së shumti ta ndërrojnë partinë e tyre të preferuar.


Në këtë kontekst, ndryshimi i partive shihet si një nga



faktorët kryesor të demokratizimit të vendit. Ndryshimi i shtyn partitë që vazhdimisht të evoluojnë dhe të përmirësojnë përfaqësimin e qytetarëve.

Më të rinjtë shfaqin shkallën më të lartë të responentëve që nuk kanë votuar ose janë përgjigjur me ‘nuk e di’ (26%), ndërsa në grupet e tjera moshore vetëm 1-5% janë përgjigjur me “nuk e di”). Të moshuarit dhe të moshës së mesme priren të jenë më besnikët në zgjedhjen e partisë së tyre (36-40% prej tyre).

A ishte vota e juaj për partinë e njëjtë sikur në zgjedhjet e mëparshme? (sipas punësimit)



Qershor 2014

Një klasifikim sipas shkollimit tregon se kategoria e individëve me shkollim të mesëm e ka tendencën më të lartë për ta ndërruar votën e tyre (24% prej tyre, krahasuar me 12-15% për kategoritë më pak të shkolluara). Përveç pyetjes se për kë do të votonit dhe nëse e kanë ndërruar votën e tyre, ne i kemi pyetur edhe për atë se cila parti do të ishte zgjedhja e tyre e dytë.


## *Zgjedhja e dytë*

Në zgjedhje, preferenca e dytë ka rëndësi, sidomos në zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe në zgjedhjet presidenciale. Zgjedhja e dytë po ashtu është një mënyrë e dobishme për ta matur orientimin e mundshëm të votuesve të hidhëruar dhe pranueshmërinë sa u përket përlogaritjeve në lidhje me koalicionin. Grafiku më poshtë paraqet preferencat e dyta më të shpeshta.

LDK e ka përmirësuar imazhin e saj në mesin e simpatizantëve të partive të tjera, ku së bashku me VV-në janë partia me më së shumti gjasa që të fitojnë votat e zgjedhjes së dytë.

Nëse partia e juaj e preferuar nuk do të garante, cila do të ishte zgjedhja e juaj e dytë?

---



Si shenjë e opinioneve të formuara në vitin 2012, gati dy të tretat e votuesve nuk kishin një preferencë se për kë do të votonin nëse partia e tyre nuk do të garonte, por kjo shkallë ka rënë mjaft në vitin 2015. LDK, PDK dhe AKR do të votoheshin si zgjedhje e dytë më shumë nga gratë, ndërsa AAK dhe VV nga burrat.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten rezultatet e anketës për kë do të orientoheshin votuesit nëse partia e tyre e preferuar nuk do të garonte. Partitë nëpër rreshta paraqesin zgjedhjen e parë, ndërsa shtyllat paraqesin përgjigjet sa u përket zgjedhjeve të dyta.

Mars 2015		Zgjedhja e II-të						
		LDK	PDK	AAK	VV	Tjerët	NV	ND/ Ref
Zgjedhja e I-rë	LDK	-	13%	11%	33%	12%	27%	4%
	PDK	37%	-	7%	21%	9%	25%	1%
	AAK	39%	5%	-	22%	19%	5%	10%
	VV	27%	7%	12%	-	24%	26%	4%
	Tjerët	13%	16%	15%	29%	-	11%	16%


Nëse LDK nuk do të garonte, 13% e votave të saj do t'i shkonin PDK-së, 11% AAK-së, dhe 33% për VV. Nëse PDK nuk do të garonte, 37% të votave të saj do t'i shkonin LDK-së, pasuar me 21% për VV-në. LDK po ashtu do të merrte shumicën e votave të AAK-së dhe VV-së. Nuk ka trend gjinor sa i përket zgjedhjes së dytë.

### *Popullariteti i liderëve në mesin e simpatizantëve të partive të tjera*


Për të nxitur një krahasim ndërmjet partive, në anketë respondentët janë pyetur se si ndjehen ata sa i përket preferencës së tyre për emra të veçantë. Qëndrimet ndaj zyrtarëve politik janë paraqitur në disa grafikone sipas përkatësisë partiake (janë matur se për kë do të votonin ata

nëse zgjedhjet do të mbaheshin këtë të dielë), për të përfituar shkallën e pranueshmërisë së zyrtarëve në mesin e simpatizantëve të tyre, si dhe përgjatë rangjeve partiake. Në mesin e simpatizantëve të LDK, pas Isa Mustafës, zyrtarja më e popullarizuar është Mimoza Kusari, e pasuar nga kryetari i komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti dhe Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga. Në mesin e simpatizantëve të PDK, pas Hashim Thaçit, lideri më i popullarizuar është Shpend Ahmeti, Mimoza Kusari dhe Kadri Veseli. Në mesin e simpatizantëve të VV, lideri me bindje më të favorshme ishte Shpend Ahmeti. Albin Kurti rangohet i dyti, me një shkallë më të ulët të “shumë i preferuar”, por shkalla më e lartë e përgjigjeve “të preferuara” krahasuar me Ahmetin. Kryetari aktual Ymeri renditet i treti, i pasuar nga Kusari dhe Haradinaj. Respondentët që nuk u përkasin PDK, LDK ose VV e kanë ranguar Kusarin si më të preferuarën, e pasuar nga Ahmeti dhe Haradinaj. Mustafa dhe Jahjaga gëzojnë popullaritet më të madh në mesin e grave, ndërsa nuk ka ndonjë trend gjinor për liderët e tjerë.


**Mendimet e votuesve për liderët politik (adhuruesit e LDK-së)**



**Mendimet e votuesve për liderët politik (adhuruesit e PDK-së)**




**Mendimet e votuesve për liderët politik (adhuruesit e VV-së)**





**Mendimet e votuesve për liderët politik (adhuruesit e partive të tjera)**



## Konkluzionet

Meqë Kosova po e arsimon një pjesë më të madhe të fuqisë së saj punëtore, të rinjtë do të bëhen shumë më kritik, do të bëhen më kërkues dhe do t'i ndërrojnë preferencat politike më shpesh. Liderët do të vlerësohen më shumë për performancën e tyre pasi që politika do të bëhet më pak personale dhe radioaktive. Hapësira më e madhe për votues të rinj mbetet në mesin e grave që votojnë më pak dhe për interesat e të cilave nuk kujdeset asnjëri nga grupet e tjera.

Nëpërmjet tabelave dhe grafikëve të shumtë, ky punim synon të nxisë debat të përgjithshëm brenda institucioneve sa u përket vendimeve politike që lidhen me zgjedhjet, p.sh., fletëvotimet ku të vihet vetëm një shenjë, saktësia e listave të votuesve, mos mbajtja e zgjedhjeve të shumëfishta në një ditë, heqja e votës preferenciale dhe e fletëvotimit me kusht. Për t'i kaluar këto ndryshime të reja, Kuvendi duhet të iniciojë një grup punues që do të diskutonte se si të përmirësohen (a) përfaqësimi dhe pjesëmarrja, dhe (b) aranzhimet teknike sa i përket procesit të zgjedhjeve. Një Kod Zgjedhor gjithëpërfshirës do të duhej të kalonte jo më vonë se deri në fund të vitit 2016.

Ky punim gjithashtu mëton të nxisë debat brenda secilës parti politike, lidhur me imazhin e tyre, politikat për të cilat ato angazhohen dhe se si ato tentojnë të depërtojnë tek grupe të caktuara votuesish. Partitë duhet të hulumtojnë mënyra për të depërtuar deri te gratë dhe te të rinjtë, si dy grupimet kryesore ku performanca e partisë mund të përmirësohet në mënyrë më drastike. Partitë duhet të kërkojnë që jo vetëm ta përmirësojnë pozicionin e tyre karshi simpatizantëve të dëshiruar, por po ashtu të bëhen zgjedhja e dytë më e preferuar e një spektri të gjerë votuesish. Anëtarësia dhe afërsia me partinë janë tregues të fortë të ndryshimit të votuesve, gjë të cilën partitë duhet të përpiqen ta kuptojnë. Partitë të cilat kërkojnë nga kryetarët e vet të komunave dhe

këshilltarët e tyre komunale të jenë të pranishëm në tërë komunitetin ka të ngjarë të rriten.

Liderë të caktuar duhet të kërkojnë mënyra të bëhen më të pranueshëm gjerësisht, pa e humbur përkrahjen e tyre tek ithtarët e tyre. Përveç betejave të brendshme partiake, ata duhet të brengosen se si mund ta bëjnë publikun të bie sërish në dashuri me ta.

## Lista e publikimeve

### Zgjedhjet dhe partitë politike:

#1: Instituti D4D. Shtator 2011. Zbërthimi i trendeve zgjedhore 2000-2010.

#2 Instituti D4D. Mars 2012. Reformë sa për adet: Si ta rikthejmë besimin në zgjedhje?

#3 Malazogu, Leon, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Nëntor 2012. Auditimi i listës së voutesve të Kaçanikut: Mostër për Kosovën.

#4 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shkurt 2013. Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme: Analizë e zgjedhjeve për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik.

#5 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Interpretimi i besimit – Perceptimi i përfaqësimit dhe i pjesëmarrjes.

#6 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Reforma zgjedhore: Dy vite pas, reforma në pikën zero

#7 Leon Malazogu dhe Brenna Gautam; me kontributin e Rezarta Delibashzades & Ngadhuj Halilajt. 26 nëntor 2014. Busolla ideologjike e Kosovës – Hartë e orientimit të partive politike

#8 Dardan Berisha me kontributin e Driton Qeriqit, Mjellma Hapciut dhe Rina Vokshit. Korrik 2015. Sjellja e drejtësisë në zgjedhje

#9 Leon Malazogu me kontributin e Ngadhuj Halilajt dhe Rezarta Delibashzade. Korrik 2015. Trendet zgjedhore 2000-2014: Analiza numerike e pjesëmarrjes dhe e përfaqësimit. Korrik 2014.

### Marrëdhëniet etnike:

#1 Malazogu, Leon dhe Vladimir Todorić. Nëntor 2011. Dialogu Beograd-Prishtinë: Nevojitet transformimi i interesit vetanak. PER-K/ Instituti D4D dhe NPC-Beograd

#2&3 Malazogu, Leon, Viktor Popović dhe Shpend Emini. Mars 2012. Perspektiva e një të riu serb në Kosovë/Jeta urbane në vendbanime me shumicë serbe në Kosovë. PER-K/D4D.

#4 Malazogu, Leon dhe Florian Bieber. Shtator 2012. Raportet në

mes të Prishtinës dhe Beogradit në të ardhmen. PER-K/ Instituti D4D.

#5 Malazogu, Leon dhe Alex Grigorev. Shtator 2012. Nga paqartësia kreative në proces konstruktiv: Si t'i qasemi veriut të Kosovës? PER-K/ Instituti D4D

#6 Ejdus, Filip, Leon Malazogu dhe Milan Nic. Tetor 2013. Municipal Elections in Northern Kosovo: Towards a New Balance? E publikuar bashkërisht nga CEPI, BCSP dhe D4D.

### **Interesi publik:**

#1: Sejdiu, Dardan dhe Kastriot Jahaj. Janar 2013. Taksa e fshehur: Pse kosovarët paguajnë më shumë?

#2: Gashi, Drilon dhe Shoghi Emerson. Maj 2013. Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë.

#3: Sutaj, Visar dhe Leon Malazogu. Janar 2013. Le të ngritet shoqëria civile e vërtetë! Roli i shoqatave me anëtarësi në formësimin e vendim-marrjes në shërbim të interesit publik.

#4 Miftari, Naser. Shtator 2013. Sfida e konsolidimit: Fuqizimi i pavarësisë së institucioneve të medias në Kosovë.

#5 Miftari, Naser. 2013. Starting from Scratch: The Role of Media Assistance in the Establishment of Independent Media Institutions in Kosovo. Working Paper 4, published by Analitika – Center for Social Research& D4D.

#6 Ardiana Gashi dhe Artane Rizvanolli; me kontributin e Natalya Wallin, Rezarta Delibashzade dhe Ngadhujim Halilaj. 25 shkurt 2015. Sa kushton patriarkati?.

### **Memorandumet:**

#1 Instituti D4D. Nëntor 2012. Reagimi i tepruar i policisë

#2 Instituti D4D. Dhjetor 2012. Modeli i dy Gjermanive

#3 Instituti D4D. 12 Korrik 103. Kritere të qarta për komunat e reja

#4 Instituti D4D & Qëndrim Gashi. Janar 2013. Memorandum reagues nr. 4 – Universiteti i Prishtinës në rreth vicioz

#5 Instituti D4D & Kushtrim Palushi. Janar 2013. Memorandum

## reagues nr. 5 – Reforma zgjedhore

### **Rekomandimet:**

#1 Instituti D4D. 29 nëntor 2011. Struktura e KOZ-së

#2 Përpiluar nga Instituti D4D. 17 janar 2011. Sistemi zgjedhor

#3 Përpiluar nga Instituti D4D. 29 nëntor 2011. Riparimi i listës së votuesve

#4 Përpiluar nga Instituti D4D. 12 dhjetor 2011. Rekomandimet për zgjedhjen e Presidentit të Kosovës

#5 Përkrahur nga: D4D, KIPRED, INPO, KMDLNJ, INDEP, DT, KHK, QPA, dhe NOMP. Për reformë të mirëfilltë zgjedhore

#6 Instituti D4D. 20 dhjetor 2011. Prezantimi i sistemit zgjedhor

### **Indikatorët:**

#1 Instituti D4D. Nëntor 2010. Para dhe pas, performanca e bazuar në indikatorë: Shqyrtimi vjetor 2010

#2 Instituti D4D. Shteti në pasqyrë: Indikatorët e bazuar në performancë.

#3 Malazogu, Leon. Nëntor 2013. Agreement in None, Including Its Name: Kicking the Can Will No Longer Bring the Sides Closer Around the Association/Community

#4 Malazogu, Leon. Janar 2014. Parashikime dhe skenare: Kosova dhe bota në 2014

### **D4D në publikimet e tjera:**

Seria e përkrahjeve dhe rekomandimeve mund të gjenden edhe në faqen tonë të internetit: ([www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org))

## Endnote

---

<sup>1</sup>Leon Malazogu dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Interpretimi i besimit. Seria e D4D mbi zgjedhjet, Punimi #6, [http://d4d-ks.org/assets/D4D\\_Elections\\_6\\_SHQ\\_WEB.pdf](http://d4d-ks.org/assets/D4D_Elections_6_SHQ_WEB.pdf).

<sup>2</sup>D4D. Shtator 2011. Zbërthimi i trendeve zgjedhore 2000-2010. [http://d4d-ks.org/assets/2012/09/2011-09-04-Zgjedhje-Zberthimi-i-trendeve\\_zgjedhore.pdf](http://d4d-ks.org/assets/2012/09/2011-09-04-Zgjedhje-Zberthimi-i-trendeve_zgjedhore.pdf).

<sup>3</sup>[http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Flet%20sq%20sr\\_batsfejqno.pdf](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Flet%20sq%20sr_batsfejqno.pdf)

<sup>4</sup> Këto rezultate përjashtojnë komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicën Veriore. Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). REKOS 2011. <http://census.rks-gov.net/istarMDEE/MD/dawinciMD.jsp?a1=WC&a2=mo0&n=1UR90600V71&o=0D&v=1UR060DS00V71000000&p=0&sp=null&l=0&exp=0>.

<sup>5</sup>Leon Malazogu, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Nëntor 2012. Auditimi i listës së votuesve të Kaçanikut. Seria e D4D mbi zgjedhjet, Punimi #3. <http://d4d-ks.org/assets/Elections-VotersListShqip.pdf>.

<sup>6</sup>Leon Malazogu dhe Brenna Gautam. Nëntor 2014. Busolla politike e Kosovës. Seria e D4D mbi zgjedhjet & partitë politike, Punimi #8. <http://d4d-ks.org/assets/Busolla-ideologjike-e-Kosov%C3%ABs1.pdf>.

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

324(496.51)“2000/2014”(047)

Trendet zgjedhore 2000-2014 : analizë numerike e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit / punimi i përgatitur nga Leon Malazogu. - Prishtinë : Demokraci për zhvillim, 2015 . – 91 f. : ilustr. me ngjyra ; 21 cm. - (Seria : Zgjedhjet dhe partitë politike ; 9)

1.Malazogu, Leon

ISBN 978-9951-608-38-1



Demokracia për zhvillim (D4D) është një organizatë ekspertësh e themeluar në vitin 2010 me vizionin se demokracia është një parakusht për zhvillim. Themeluesit e D4D besojnë se demokracia është mjet dhe qëllim për zhvillim dhe ata i kanë caktuar vetes për detyrë misionin që të hulumtojnë dhe të përfshijnë një komunitet më të gjerë të bartësve që ky qëllim të dalë në pah.

Misioni i D4D-së është të ndikojë në zhvillimin e politikave publike për të përshpejtuar zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës, për të përmirësuar qeverisjen, dhe forcuar kulturën demokratike në vend.

Për më shumë informata për aktivitetet e D4D, ju lusim ta vizitoni faqen tonë të internetit në: [www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org).



Ministry of Foreign Affairs of the  
Netherlands



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA



ISBN 978-9951-608-38-1



9 789951 608381